
përmbajtja











Portreti i muajit: Më në fund Basha 2

Milazim Krasniqi: Bashkimi Europian në rolin e rindezësit të sherrit? 3-5

Muhamet Jahiri: Shënohet suksesi i parë i bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë 6-7

Gëzim Qerimi: Protesta për xhami 7-8

Valbona Kelmendi: Le të mendojmë së bashku 9-10

Osman D. Gashi: Kur përzihen gjërat.............. 10-11

Qëndresë Mustafa: Rregullorja për organizimin e gjykatave e gatshme për shtator 12

Lulzim Ahmeti & Besnik Boletini: Ligji i punës (nuk) zbatohet 13-15

Intervistë me Musa Dragushën 16-18

Muhamed J. Kajolli: Në nderim të shtatë dëshmorëve 19-22

Astrit Veliqi: Humbet lumturia, shtohen divorcet në Kosovë 23

Ndriçim Hoxhaj: Sesion përkujtimor për Hoxhë Tahsinin 24-25

Khaled Schmidt: Nuk do të kishte internet pa dijetarin islam El – Havarizmin 25

Muhamed J. Kajolli: Rikthimi në monarki..... 26-29

John Esposito & Dalia Mogahed: Ta marrim vesh mirë: pranveraarabe kërkon një tregim të ri .. 30-31

The Economist: NATO e lodhur me Libinë ... 31-32

Shejh 'Abdulkadir Al-Murabit: Gëte si musliman. 33-34

Intervistë me ministrin Memli Krasniqi.......... 35-37

Artan Bejta & Jehona Sahiti: Mirë se vjen verë, kujdes nga dielli 38

Intervistë me basketbollistin Blerim Mazreku . 39-40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti VI / Nr. 56
19 korrik - 19 gusht 2011
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Avni AVDIU
avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!



Tabela e rezultatit sipas KQZ-së

Numri i zgjedhësve që kanë votuar	256507
Fletë votimi të papërdorura	226205
Fletë votimi të dëmtuara	1680
Fletë votimi të gjetura në kuti	257377
Vota të pavlefshme	5362
Vota të vlefshme	251389

Shpëmdarja e votave të vlefshme

Edi Rama	124949
Hysni Milloshi	1398
Lulzim Basha	125042
Gjithsej vota të vlefshme	251389

Portreti i muajit

MË NË FUND BASHA

Data 8 korrik 2011 i ka dhënë fund maratonës juridike për zgjedhjet lokale të 8 majit në Tiranë, duke vulosur Lulëzim Bashën si kryetar të ri të bashkisë. Pasi ka dëgjuar palët dhe ka administruar provat një ditë më parë, Kolegji Zgjedhor në Gjykatën e Apelit në kryeqytet, me relatore Sashenka Jonuzin, ka vendosur të rrëzojë padinë e Partisë Socialiste ndaj vendimit nr. 1160 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me anë të të cilit PS shpresonte një shqyrtim në themel të çështjes dhe me gjasë shpalljen e pavlefshmërisë në 284 qendra votimi. Pas ditëve ulje- ngritje në rezultat, nga njësia në njësi, shifrat e prodhuara në KZAZ-të e Tiranës, të bllokuara periodikisht nisën të përvijojnë një rezultat paraprak që u projektua në një garë shumë të fortë mes Lulëzim Bashës dhe Edi Ramës. Me pjesëmarrjen e ambasadorëve të Perëndimit, KZAZ-ja nr. 49, e drejtuar nga demokratët u detyrua të mbyllte numërimin e votave, sipas të cilit kreu socialist, Edi Rama rezultoi fitues me 10 vota para. Por ajo që u shoqërua me deklarime feste dhe gëzimi nga PS-ja, u errësua nga procedura e vënë në lëvizje nga demokratët, të cilët u kujdesën që të bënin dy veprime nga pikëpamja juridike; e para KZAZ-ja nr. 49 nuk e miratoi tabelën përmbledhëse të rezultateve, pavarësisht përfundimit të numërimit dhe prej këtej kjo solli që edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të mos pasqyronte rezultatin në sajtin e vet elektronik, ku shifrat përditësoheshin në kohë reale. Ky moment, së bashku me procedurën e kontestimit të fletëve gjatë numërimit, i dhanë PD-së argumentin për të nisur procedure juridike, fillimisht në KQZ.

BIOGRAFIA:

Lulëzim Xhelal Basha lindi më 12 qershor 1974. Është jurist i specializuar në të drejtën Evropiane dhe Ndërkombëtare Publike në Universitetin e Utrechtit në Holandë. Ka lindur në Tiranë, kurse familja e tij është me prejardhje nga Drenica e Kosovës. Në vitet 40-të të shekullit të kaluar gjyshi i tij u detyrua të ikte nga Kosova pas torturave serbe. Gjatë periudhës maj 1998 – korrik 1999 ishte pjesëtar i skuadrës së hetimit të krimeve të luftës nga forcat serbe në Kosovë: Tribunali Ndërkombëtar për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi. Gjatë periudhës korrik 2000 – tetor 2001 ushtronte detyrën Këshilltar Ligjor në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut. Gjatë periudhës tetor 2001 - nëntor 2002 vepronte si Zëvendës Shef i Kabinetit të Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë në UNMIK. Gjatë periudhës nëntor 2002 – janar 2005 veproi si Këshilltar Special për Tranzicionin në Departamentin e Drejtësisë në UNMIK dhe Përgjegjës për përgatitjen e tranzicionit të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut drejt një Ministrie të Drejtësisë të Kosovës. Nga janari i vitit 2005 dhe në vazhdim veproi si Koordinator i Komitetit të Orientimit të Politikave në Partinë Demokratike në Tiranë. Përgjegjës për koordinimin e punës së ekspertëve dhe komisioneve të KOP në përgatitjen, diskutimin dhe shpalljen e 17 projekt- platformave qeverisëse nga KOP për Partinë Demokratike të Shqipërisë. Nga prilli i vitit 2005 dhe në vazhdim është anëtar i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Nga maji i vitit 2005 dhe në vazhdim është anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Shqipërisë. Gjatë periudhës maj – korrik 2005 vepron si Zëdhënës i Fushatës Zgjedhore 2005. 2005 - 2007 Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe gjatë 2009 - 2011 Ministër i Brendshëm.

Bashkimi Europian në rolin e rindezësit të sherrit?

Milazim KRASNIQI

Mënyra e imponimit nga ana e Bashkimit Europian të dialogut ndërmjet Prishtinës e Beogradit dhe të tri marrëveshjeve të para ndërmjet tyre, teknikisht është e ngjashme me mënyrën se si pleqnarët hileqarë kanë pajtuar palët në konflikt: pala më e dobët shtrëngohet të bëjë më shumë lëshime dhe ashtu arrihet pajtimi/ marrëveshja e imponuar dhe e padrejtë. Në të vërtetë, Bashkimi Europian që nga fillimi e ka imponuar këtë dialog, për t'i bërë favore Serbisë. Favori kryesor ka të bëjë me krijimin e ambientit që në fund të vitit 2011 Serbisë t'i jepet statusi i shtetit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian. Marrja e atij statusi pastaj do të jetë një kartë e fuqishme në duart e Boris Tadiqit, në mënyrë që në zgjedhjet e vitit 2012 të marrë edhe një mandat tjetër për qeverisje në Serbi. Sipas kalkulimeve të strategëve të Bashkimit Europian, edhe një mandat i ri katërvjeçar i një qeverie proeuropiane, sikundër e konsiderojnë ata qeverinë e Tadiqit, do të ishte i mjaftueshëm, që Serbia të shkëputet nga përqafimi i ariut rus dhe për ta integruar në mënyrë të pakthyeshme në strukturat europiane. Këto janë kalkulime, të cilat për mungesë të fuqisë së europianëve, madje edhe për mungesë të vullnetit që edhe atë fuqi që e kanë ta përdorin për ta detyruar Serbinë të shkëputet nga bataku nacionalist dhe rusofil, bëhen në dëm të fqinjëve më të dobët të Serbisë, në rend të parë ndaj Bosnjës e Hercegovinës dhe ndaj Kosovës. (Përpjekja e para disa viteve e Bashkimit Europian që të mbahej Mali i Zi i lidhur pas qerres së Serbisë, ishte po ashtu një përpjekje hipokrite dhe bizare, kur iu imponua Malit të Zi që referendumi për pavarësi të arrinte rezultatin prej 54 për qind e jo ashtu si është kudo në botë, 50 plus një.) Bashkimi Europian në kalkulimin e vet duket në shikim të parë racional: llogaritë se favoret që po ia bën Serbisë janë një lojë taktike, sepse kur vjen puna te anëtarësimi, do ta detyrojë të heqë dorë nga ambiciet e saj nacionaliste dhe nga favoret e fituara në dëm të Kosovës e të Bosnjes, gjatë rrugës së integrimit. Por, kjo është një lojë shumë e rrezikshme e Bashkimit Europian, e cila në të kaluarën i ka kushtuar shumë jetë njerëzish rajonit. Taktikë të ngjashme pati përdorur Bashkimi Europian ndaj Serbisë, edhe pas Marrëveshjes së Dejtonit, me ç'rast shtetit gjakatar të Millosheviqit i pati dhënë edhe preferenciale ekonomike. Por, Serbia nuk u europianizua nga ato preferenca ekonomike. Përkundrazi, paratë e marra me atë rrugë, i përdori për ta realizuar projektin e spastrimit etnik të Kosovës. Ekziston rreziku potencial që të përsëritet sjellja e atëhershme e Serbisë, pas gjithë këtyre favoreve pa karar që po ia bën Bashkimi Europian, në dëm të Kosovës e të Bosnjës e Hercegovinës. Është shumë e mundshme që formulën e tashme të Tadiqit "Edhe Kosovën, edhe Europën", vetë Tadiqi ose ndonjë drejtues tjetër i shtetit serb, ta zëvendësojë me formulën e Jeremiqit (e të Koshtunicës), "ndërmjet Europës dhe Kosovës, zgjedhim Kosovën." Kjo mund të ndodhë madje që në zgjedhjet e vitit të ardhshëm, nëse Tadiqit nuk i mjafton për fitore as gjithë arsenali politik dhe propagandstik i Brukselit, i cili është vënë tërësisht në shërbim të tijin. Pse? Paaftësia e qeverisë së Tadiqit që ta luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar, e bashkuar me pasojat e



Gjatë një takimi dialogues

Edita Tahiri · Catherine Ashton · Robert Cooper · Borko Stefanoviç

krizës ekonomike të tejzgjatur, ka krijuar pakënaqësi të madhe te qytetarët serbë, të cilët në një moment mund t'ia kthejnë bërrylin partisë së tij. Në një rast të tillë, i gjithë investimi i Bashkimit Europian për europianizimin e Serbisë do të shumëzohej me zero, sepse do të ktheheshin në pushtet forcat nacionaliste dhe rusofile, të cilat të vetmen gjë që do ta merrnin në konsideratë do të ishte trashëgimia imperiale e regjimit të Tadiqit, për ta finalizuar me një agresion edhe më të madh, ndoshta edhe ushtarak, në drejtim të Kosovës. (Sot shumëkujt ky skenar i duket i pamundshëm, por edhe në kohën e Titos shumëkujt i është dukur e pamundshme ajo që ndodhi në vitet e nëntëdhjetë në hapësirat e ish-Jugosllavisë). Vetë fakti që edhe Tadiqi, e lëre më nacionalistët radikalë, thonë se kurrë nuk do ta pranojnë shtetin e Kosovës, është argument se ndërmjet Kosovës e Serbisë ka vetëm një armëpushim të imponuar nga Fuqitë e Mëdha e jo një paqe të qëndrueshme. Prandaj, loja e Bashkimit Europian me favoret ndaj Tadiqit në dëm të Kosovës e të Bosnjës, është shumë e rrezikshme, sepse kërcënon të bëjë të kontestueshme pavarësitë e këtyre dy vendeve dhe të kthejë edhe konfliktet e armatosura në vitet e ardhshme. Kjo mund të ndodhë nëse prishen ekuilibrat e brishtë gjeopolitikë të arritur pas Marrëveshjes së Dejtonit (1995) dhe Marrëveshjes së Kumanovës (1999), sepse në atë rast do të ballafaqohemi me ringjalljen e apetiteve aneksioniste dhe imperiale të Serbisë. Fatkeqësisht, hapi i parë në këtë ringjallje të apetiteve imperiale serbe ndaj Kosovës është pikërisht dialogu teknik ndërmjet Beogradit e Prishtinës, të cilin Serbia po e shfrytëzon për ta legalizuar prezencën e saj shumëplanëshe në vend. Në një debat televiziv në B92, pas arritjes së tri kuazimarrëveshjeve të para, kryenogeciatori serb, Boruisllav Stefanoviqi, tekstualisht deklaroi se "Serbia është në Kosovë me të gjitha institucionet, përveç ushtrisë". Dialogu tash po përdoret pikërisht për t'i legalizuar ato institucione, e jo për t'i shuar, sikundër ka deklaruar Edita Tahiri. Krijimi i ekipeve të përbashkëta për implementimin e kuazimarrëveshjeve do të përdoret nga Serbia që strukturat serbe të legalizohen dhe të arrijnë në një pikë sa të shpallin se bashkëqeverisin me "organet e përkohshme të Prishtinës". Ky është synimi i qartë i Serbisë dhe në ambientin



Palët gjatë dialogut, nga e majta pala e Kosovës, nga e djathta pala e Serbisë

ku Bashkimi Europian nuk ia prishë as tymin e duhanit, kjo ka mundësi që të realizohet, me ç'ka do të minonte seriozisht themelet e shtetit tonë të ri. Në këtë kontekst, Stefanoviqi ka pohuar se në pjesën veriore nuk ka struktura paralele, po ka ekskluzivisht struktura të shtetit serb. Dialogu po e shpie punën në drejtim të legalizimit të tyre dhe të inkorporimit të tyre si struktura të sistemit të qeverisjes në Kosovë. Prej aty krijimi i një entiteti serb në veriun e Kosovës, do të ishte një veprim vetëm teknik.

Në bazë të sjelljeve të Bashkimit Europian, i cili Kosovën po e mban në një presion të egër psikologjik e politik, ndërsa Serbisë po i bën favore të mëdha, është e dukshme tendenca që kjo edhe të ndodhë realisht. Një entitet serb në Kosovë, do të ishte një gur i rëndë në qafën e shtetit të ri, i cili nuk do ta linte kurrë ta mbajë kokën drejt, e lëre më që ta ngrejë kokën lart. Strategët në Bashkimin Europian, me prejardhje nga shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën dhe mercenarët e ndryshëm si puna e Karla del Pontes e Dik Martit, që kanë armiqësi patologjike ndaj Kosovës, nuk do të lënë gur pa lëvizur për të krijuar një entitet serb në veri të Kosovës. Aktualisht, kjo rrymë është shumë e fuqishme në institucionet europiane, aq sa në fakt ata e hartojnë politikën e izolimit të Kosovës, me qëllim që ta gjunjëzojnë ekonomikisht, ta komprometojnë politikisht dhe ta detyrojnë që të pranojë projektin e tyre për entitetin serb në veri të vendit. Kjo frymë



dëbimit të Serbisë nga Kosova. Kjo është tipike për logjikën e atyre pleqnarëve të padrejtë që u përmendën në fillim të këtij teksti.

Por e vërteta është se, sipas fjalëve të Borisllav Stefanoviqit, "Serbia edhe pas këtyre marrëveshjeve nuk e ndërpret funksionimin e vet në Kosovë", duke përfshirë këtu edhe lëshimin e dokumenteve të reja të shtetit serb. Ai po e thotë këtë publikisht dhe askush nga Bashkimi Europian nuk po e demanton. Dhe as që do ta demantojë kush, sepse Stefanoviqi dhe qeveria e tij janë në sinkron me Bashkimin Europian. Para disa ditëve Boris Tadiqi ka deklaruar se "Kosova nuk është parakusht për integrimet europiane", duke folur më shumë si zëdhënës i parapaguar i BE-së. Askush nuk ia ka demantuar deklaratat. Për më tepër, deklaratat e tij skandaloze për ndarjen e Kosovës, kanë hasur në vesh të shurdhër në Bruksel. Zyrtarët e Brukselit e kanë shprehi të mos dëgjojnë atë që nuk u pëlqen ta dëgjojnë dhe ashtu shtiren se janë gjakftohtë, ndërsa në të vërtetë në atë mënyrë përpiqen ta fshehin paaftësinë e tyre, që të menaxhojnë ndershmërisht qoftë dhe një krizë lokale. Në fakt, ata po e menaxhojnë në mënyrën më të pandershme të mundshme, duke e detyruar Kosovën të hyjë në një dialog të panevojshëm (për çështje për të cilat Serbia është dashur të japë llogari e jo të bëhet partner) dhe duke e detyruar të pranojë zgjidhje që e kërcënojnë stabilitetin e vendit dhe dinjitetin e qytetarëve të saj.

Në fakt, duhet thënë hapur: me këtë dialog të shpifur dhe me këto kuazimarrëveshje të imponuara, Bashkimi Europian po përgatit një skenar të errët për Kosovën, i cili fillon me delegjitimin e shtetit të ri, (të cilin edhe ashtu Bashkimi Europian nuk e njeh), me ndarjen e tij, e ka rrezik edhe më një konflikt të ri të armatosur, i cili mund të bëhet i pashmangshëm, në një pikë kur nacionalizmi serb do të përpiqet që t'i finalizojë fitoret e dhuruara nga Bashkimi Europian. Në qoftë se jemi gjallë, do ta shohim se skenari i zgjedhur nga Bashkimi Europian, nëse nuk korrigjohet shpejt, këtë epilog dramatik e bën të pashmangshëm. Në atë rast, Bashkimi Europian nuk do të mundet as ta aktrojë rolin e pleqnarëve hileqarë, që i bëjnë presion më të dobëtit, por do të identifikohet me rolin e atyre batakçinjve, që me hilenë e tyre e rindezin sherrin.

po dominion në shumë deklarime dhe veprime të zyrtarëve të institucioneve europiane. Prandaj, jo rastësisht Vuk Jeremiqi po deklaron se "Serbia nuk e ndien presionin e Bashkimit Europian lidhur me Kosovën". Është e vërtetë se Bashkimi Europian nuk është duke i bërë asnjë trysni Serbisë që të ndërrojë kursin e destabilizimit të Kosovës. Përkundrazi, të gjitha gjasat janë që dialogu që po zhvillohet dhe kuazimarrëveshjet që gjoja po arrihen, do ta dëmtojnë edhe më shumë Kosovën, kësaj radhe edhe me kontributin e vetë Bashkimit Europian. Mjafton të shihen elemente të këtyre kuazimarrëveshjeve për ta kuptuar këtë rrezik. Fjala vjen, krahas detyrimit që ka marrë Serbia për t'i ofruar Kosovës kopjet e librave të amzës, Kosova detyrohet t'i ofrojë Serbisë të dhënat nga librat e vet të amzës, të hartuara gjatë këtyre dymbëdhjetë vjetëve! Kush mund ta arsyetojë një imponim të tillë, sipas të cilit qytetarët e Kosovës do të vazhdojnë të administrohen paralelisht edhe nga shteti serb? Pse u dashka që dokumentet e Kosovës t'i jepen Serbisë?! A ia jep Gjermania të dhënat nga librat e amzës Francës? Apo Zvicra Italisë? Apo Sllovenia Austrisë? Pse ky detyrim poshtërues?

Kosovës i është imponuar nga Bashkimi Europian që të bisedojë me Serbinë për dokumentet që Serbia i ka plaçkitur gjatë spastrimit etnik, gjenocidit dhe kulturocidit, ndërsa Bashkimi Europian ia imponon Kosovës që t'ia jep Serbisë dokumentet e veta, dymbëdhjetë vjet pas

SHËNOHET SUKSESI I PARË I BISEDIMEVE MES KOSO

Muhamet JAHIRI

Bisedimet e nisura mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë kanë sjellë edhe marrëveshjet e para. Pas disa raundesh të bisedimeve në Bruksel, delegacionet e të dy vendeve kanë arritur tri marrëveshje për: lirinë e lëvizjes, regjistrin civil dhe njohjen e ndërsjellë të diplomave.

Pas arritjes së marrëveshjeve të para, shefja e delegacionit të Republikës së Kosovës, Edita Tahiri, ka thënë se marrëveshjet e arritura në mes të Prishtinës dhe Beogradit janë hapi i parë drejt njohjes së pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë. Ajo ka bërë me dije se tri marrëveshjet e arritura në Bruksel do të fillojnë së implementuari nga 1 nëntori i këtij viti. "Marrëveshjet fillojnë të zbatohen nga 1 nëntori. Nga kjo datë do të zbatohet ligji në gjithë territorin e Kosovës dhe do të eliminohen strukturat paralele, kurse qytetarët do të lëvizin lirshëm", - ka thënë Tahiri.

Përderisa arritja e marrëveshjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë është vlerësuar pozitivisht nga zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, nga ana tjetër përfaqësuesit e partive opozitare këto marrëveshje i kanë konsideruar të dëmshme për shtetin e Kosovës. Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Ismet Beqiri, ka thënë se marrëveshjet e arritura janë të papranueshme për faktin se Serbia nuk i njeh pasaportat dhe tabelat e automjeteve të Republikës së Kosovës. "Kjo është dëshmia më e mirë se këto marrëveshje nuk janë kurrfarë marrëveshje, përderisa Serbia nuk i pranon as pasaportat e as tabelat e Republikës së Kosovës. Serbia nëpërmjet këtyre marrëveshjeve po tenton që qytetarët e Kosovës t'i konsiderojë qytetarë të saj, duke ua mundësuar lëvizjen vetëm me letërnjoftim", - ka thënë Beqiri.

Ai ka deklaruar se këto marrëveshje janë të papranueshme për LDK-në. "Nuk ka reciprocitet ashtu siç thuhet, por ka imponim dhe jo lëvizje të lirë. Ne duhet të udhëtojmë me pasaporta të shtetit tonë dhe qytetarët e Serbisë me pasaporta të shtetit të tyre. Kjo është një lojë e ndytë e Serbisë, të cilën nuk duhet ta pranojmë në asnjë mënyrë", - ka deklaruar Beqiri.

Ai ka thënë se çdo marrëveshje e arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të shkojë për miratim në Kuvendin e Kosovës. "E mira do të ishte që në Kuvend të shihen këto marrëveshje, pastaj të miratohen ato çështje që janë në interes të shtetit dhe të qytetarëve të Kosovës", - ka thënë Beqiri.

Edhe partia e dytë opozitare, Lëvizja Vetëvendosje!, ka reaguar në lidhje me arritjen e këtyre marrëveshjeve. Deputeti i këtij subjekti politik, Glauk Konjufca, ka thënë se këto marrëveshje janë në dëm të shtetësisë së Kosovës. "Me këto marrëveshje Kosova më shumë po e njeh Serbinë, ndërsa Serbia po përfiton koncesione shumë të mëdha përbrenda Kosovës. Në çdo marrëveshje Serbia po përkujdeset që të mos e pranojë Kosovën, ndërsa po merr garanci të mëdha për strukturat paralele të saj në Kosovë", - ka thënë Konjufca, duke shtuar se me arritjen e këtyre marrëveshjeve delegacioni i Kosovës është duke e dëmtuar shtetësinë e Kosovës. "Të gjitha marrëveshjet e refuzojnë shtetësinë e Kosovës. Serbia nuk i pranon pasaportat e Kosovës, por vetëm letërnjoftimet. Ajo qytetarët e Kosovës i konsideron si qytetarë të territorit të saj, pasi pasaporta konsiderohet dokument shtetëror, ndërsa letërnjoftimi dokument i karakterit civil dhe administrativ", - ka treguar Konjufca.

Ai ka thënë se me vetë faktin se Kosova i ka pranuar kopjet e regjistrit civil, Serbia paraqitet si vend amë i qytetarëve të Kosovës. "Mundëson marrjen e kopjeve, ndërsa mban origjinalin. Edhe sa iu përket tabelave të automjeteve, Serbia nuk i pranon ato me Republikën e Kosovës. Edhe kjo është në dëm të shtetit tonë", - ka thënë Konjufca.

Arritjen e këtyre marrëveshjeve në mes të dy delegacioneve nuk e ka pritur mirë as Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).



Deputeti i këtij subjekti politik, Ahmet Isufi, ka theksuar se marrëveshjet janë të dëmshme për Kosovën për faktin se nuk i ka firmosur asnjëra palë. “Këto marrëveshje janë të dëmshme për Kosovën për arsye se nuk janë të nënshkruara së pari si marrëveshje, të cilat obligojnë Serbinë para faktorit ndërkombëtar dhe institucioneve të Kosovës, por më shumë janë një blof politik që nuk sjell ndonjë dobi për qytetarët e Kosovës”, - ka deklaruar Isufi. Ai ka thënë se angazhimi i institucioneve të Kosovës në këto bisedime me Serbinë është vetëm humbje kohe dhe manipulim me opinionin. “Angazhimi në këto bisedime, që të ketë marrëveshje me Serbinë, është vetëm humbje kohe e kësaj Qeverie dhe manipulim me opinionin se gjoja po bëhen lehtësime për qytetarët e Kosovës. Serbia është një shtet që nuk i përfill marrëveshjet dhe shpeshherë i ka thyer ato”, - ka thënë Isufi.





Protesta për xhami

Bashkësia Islame e Kosovës, vazhdon të këmbëngulë në kërkesën për ndërtimin e një Xhamie në qendër të Prishtinës. Organizata të tjera joqeveritare të besimit islam, kanë të njëjtën kërkesë dhe tri namaze të së premtes (xhumasë) i falën në rrugë, duke bërë presion mbi kuvendin komunal të Prishtinës, që t’u ndajë lokacionin për ndërtimin e xhamisë. Ata kërkojnë që xhamia të ndërtohet në qendër të Prishtinës, afër katedrales "Nënë Tereza"

Gëzim QERIMI

Bashkësia Islame e Kosovës dhe disa organizata joqeveritare të besimit islam, vazhdojnë të kërkojnë që në qendër të Prishtinës, komuna t’u ndajë një lokacion për ndërtimin e një xhamie të madhe, e cila do të përmbushte kërkesat e besimtarëve muslimanë për të kryer ritet fetare. ‘Bashkësia Islame e Kosovës kërkon ndërtimin e xhamisë në qendër të Prishtinës, mirëpo nuk qëndron prapa protestave në rrugë të besimtarëve muslimanë, të cilët gjatë një proteste u përleshën me policinë e Kosovës’ - kështu thotë zyrtari i lartë i Bashkësisë Islame të Kosovës, Resul Rexhepi.

“Një pjesë e vogël e shoqërisë civile, organizata joqeveritare kanë ndërmarrë masa duke pretenduar se ata po mbështesin Bashkësinë Islame të Kosovës, kërkesë të cilën ne e kemi paraqitur vite më parë në kuvendin komunal të Prishtinës. Pra, ne nuk qëndrojmë prapa protestave,” - thotë Resul Rexhepi.

Kjo kërkesë është bërë vite më parë, por komuna akoma nuk ka gjetur një lokacion për ndërtimin e xhamisë. Ndërsa në të gjitha xhamitë e Prishtinës, gjatë katër stinëve të vitit, mbi 70% e xhematit falen jashtë xhamive si rezultat i numrit të madh të besimtarëve muslimanë që falin namazin e xhumasë. Duke u nisur nga ky realitet, me mijëra besimtarë muslimanë, tri të premte radhazi, bënë faljen e xhumave në ambiente të hapura, si shenjë proteste dhe presioni për të realizuar kërkesën e tyre të hershme. Njëri nga organizatorët e protestave, Fuad Ramiqi, tha se: “Që 12 vjet ne bëjmë namaz jashtë, në temperatura ekstreme, në të ftohtë, në të nxehtë, në shi dhe në borë dhe në pritje të klasës politike, qoftë të nivelit qendror dhe lokal, që kërkesa jonë të realizohet. Me protestat tona si shoqëri civile, ne e kemi parë të arsyeshme që t'i japim një mbështetje edhe Bashkësisë Islame të Kosovës”, - tha Fuad Ramiqi.

Sidoqoftë, protestuesit e besimit musliman vazhdojnë të këmbëngulin në realizimin e kërkesës për ndërtimin e një xhamie të madhe në qendër të Prishtinës, si dhe të ndërtimit të një qendre të madhe islame. Madje ata i kanë dhënë një afat një gushtin kuvendit komunal që të ndajë lokacionin për ndërtimin e xhamisë, në të kundërtën protestat do të radikalizohen.



Zëdhënësi i komunës së Prishtinës, Muhamet Gashi, tha se komuna është në kërkim të lokacionit për ndërtimin e xhamisë, mirëpo komuna sipas tij nuk pranon afate kohore. "Komuna e Prishtinës do të përfillë të gjitha procedurat ligjore për caktimin e lokacionit dhe nuk mund të jetë një gushti datë e saktë kur do të ndahet lokacioni, mirëpo procedurat tashmë kanë filluar dhe duhen përfillur të gjitha procedurat ligjore", - thotë Muhamet Gashi. Por, si duket zëdhënësi i komunës nuk është i vetëdijshëm se kjo ide dhe kjo kërkesë ka ekzistuar para dhjetë viteve dhe deri më tani nuk është bërë asnjë hap konkret dhe, shikuar nga ky aspekt deklarata e tij, nuk duket serioze në raport me besimtarët islamë.

Shumë analistë thonë se mosndarja e lokacionit për ndërtimin e xhamisë së madhe në qendër të Prishtinës është një diskriminim i hapur ndaj besimtarëve islamë dhe këtë gjest e cilësojnë si gabim shumë të madh të institucioneve të Kosovës.

Sidoqoftë, me gjithë këto deklarime, ditë më parë në oborrin e Universitetit të Prishtinës disa persona filluan të hapin siç thonë ata themelet e xhamisë. Këto themele u vendosën përballë katedrales së Prishtinës, e cila u ndërtua një vit më parë, duke u rrënuar së pari një shkollë dhe mbi themelet e asaj shkolle u vunë themelet e katedrales, ndërsa vite më parë, po ashtu në mënyrë të dhunshme, ishte vënë edhe gurthemeli i kishës ortodokse serbe në oborrin e Universitetit të Prishtinës, por sot të dyja këto objekte fetare nga njohësit e kulturave dhe të rrjedhave politike cilësohen si objekte politike fetare, ndërsa kërkesa e besimtarëve islame cilësohet si kërkesë reale dhe e domosdoshme, duke pasur parasysh numrin e madh të xhematit që praktikojnë faljen e namazit dhe që kanë problem me hapësirat ku falen.

Komuna e Prishtinës, me anë të një komunikate të saj, ka shprehur interesimin e madh që kjo çështje të zgjidhet sa më parë që të jetë e mundur. Jo zyrtarisht thuhet se gjasat janë që xhamia e madhe të ndërtohet përballë fakultetit filologjik ose xhamia e madhe e Prishtinës mund të ndërtohet edhe në vendin ku aktualisht është Avokati i Popullit të Kosovës. ■



Titujt kryesorë: Veriu Imuniteti i deputetëve BE - Kosovë

Radio Evropa e Lirë
evropaelire.org

Si të dëgjohet | Orari i emisioneve | Intervista | Intervistat online | Regjistrimi | Kontaktet

E premte, korrik 15, 2011 Kosova 08:44 Kërko

Faqja kryesore
Lajmet
Aktuale
Kronika
Shtypi botëror
Rajoni
Bota
Të tjera
Multimedia

Programi i radhës

09:00 - 09:15
Programi i mëngjesit

12:00 - 12:15
Programi i mesditës

16:00 - 16:30
Programi i pasdites

Sipas kërkesës
Orari
Si të dëgjohet?
Ndihmë

KRONIKA

Kërkesë legjitime apo radikalizim i fesë?



Protesta e mbajtur për të kërkuar ndërtimin e xhamisë

03.07.2011

Bekim Bislimi

Protestat e fundit të besimtarëve mysliman për ndërtimin e një xhamie në Prishtinë, kanë nxitur reagime të ndryshme, duke mos përjashtuar edhe mendimet se po

Madhësia e shkronjave

Printoje
Email
Komenti (7)
Shpërndaje
Tweet 4
Pëlqej

Më tepër nga ky autor
- Imuniteti problematik i deputetëve
- Përplasen serbët
- Kundërshtojnë deklaratat e Rexhepit
- Veteranët e UÇK-së ende në grevë
- Kërkesa e (pa)drejtë e EULEX-it

Më tepër artikuj

Më të lexuarat
1. Kosovë, Serbi: U arritën tri marrëveshje
2. Marrëveshjet zbatohen nga 1 nëntori
3. Petifer: Bisedimet me Beogradin - të gabuara
4. Marrëveshjet nuk ratifikohen në Kuvend

LE TË MENDOJMË SË BASHKU

Valbona KELMENDI

Kushdo që jeton, patjetër që përballet me të mirën dhe të keqen, me të ëmblën e të hidhurën, me kënaqësinë e hidhërimin, me të drejtën e të padrejtën… Kjo jetë është me valë të llojllojta me të cilat përballet njeriu, madje këto pengesa janë shenja korrigjuese dhe reformuese për të, në mesin e të cilave është edhe toleranca. Tolerimi më i zakonshëm është të lëshosh pe, por jo në kuptimin që t'i bëjmë dikujt një shërbim idiotik, por në mesin e mundësive të zgjedhim atë mundësi që është më produktivja, gjegjësisht më e mira nga të gjitha të tjerat. Para se të kërkojmë nga të tjerët që të jenë tolerantë duhet të jemi vetë të tillë, p.sh. kur kemi të bëjmë me tolerancën ndërfetare, shqiptarët njihen e admirohen për këtë te popujt e tjerë. Ndoshta gjithçka duket e thjeshtë, edhe më e thjeshtë sesa që është në të vërtetë, por nga historia kemi mësuar se nëse kemi dëshirë për bashkëjetesë të mirë, atëherë duhet të jemi të drejtë, miq të sinqertë, për çdo popull, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike dhe fetare. Por duhet që kjo drejtësi e tolerancë, si e jona, të jetë e ndërsjellë dhe reciproke edhe nga të tjerët ndaj neve. Të gjitha këto krijohen dhe arrihen me punë dhe moral, ku askujt nuk i mohohet e drejta për të pasur një jetë të lumtur, ngaqë të gjithë janë njerëz dhe e kanë të drejtën e tyre për të jetuar me të drejtat që u takojnë.

Bashkëmendimi është vlerë dhe pasuri, andaj të ndjekim rrugën e ardhmërisë, të mendojmë e punojmë për të mirën e rinisë sonë në mënyrë që t'i krijohet mundësi për jetesë të mirë.

Sikurse ndjenjat e urrejtjes dhe zemërimit t'i linin vend tolerancës, shumë nga problemet aktuale nuk do të ishin sot e do të jetonim të qetë dhe me lehtësi. Faktet tregojnë që është koha e fundit që t'i ndryshojmë pikëpamjet, të cilat po na servohen në lidhje me jetën tonë, shkollimin, rendin dhe punën. Të gjitha këto duhet t'i bëjmë prioritete. Duhet ta kuptojmë dhe pranojmë realitetin ashtu siç është njëherë e përgjithmonë. Duhet ta dimë se e ardhmja nuk mund ta ndryshojë të kaluarën, por e kaluara mund ta shkatërrojë të ardhmen, andaj bashkëmendimi dhe bashkëveprimi lypset të jetë kurdoherë mes nesh.

Është shumë lehtë ta urresh dikë dhe të gjesh arsye të shumta për këtë urrejtje, por vetëm njerëzit e mençur dhe të vërtetë dinë të mos sillen gabimisht dhe vrazhdët ndaj atyre, të cilët kanë drejtë t'i kërkojnë të drejtat e tyre dhe të jetojnë me të drejtën që ju takon.

Sot është bërë modë që sinqeriteti të kuptohet vetëm nga ajo që lidhet me gjuhën, por njeriu në përgjithësi, e ai në pozitë e udhëheqje në veçanti, duhet të jetë i sinqertë në gjuhë, zemër, në punë e në vepra. Njerëzit të cilët janë të ngarkuar me përgjegjësinë e vendit e popullit të tyre duhet ta kuptojnë sinqeritetin e tyre si rolin e shpatës e cila i pret pengesat, të cilat i pengojnë për ta çuar drejtësinë drejt rrugës e cila nesër do të ruhet më shumë sesa margaritarët e vlerave me kostot më të larta. Në vazhdimësi të kësaj, sinqeriteti duhet kuptuar si qetësi e zemrës, kthjelltësi e mendimeve, kurse gënjeshtrat në premtimet e dhëna gjatë fushatave të tyre duhen flakur, ngase gënjeshtrat shkaktojnë shqetësime, lëkundje, dyshime, e që këtu shkaktojnë edhe lindjen e pakënaqësive tek ata të cilëve u bëhet e padrejtë, e që padrejtësitë e tyre i shprehin

pastaj në protestë, grevë, interpelancë e debate të nxehta, saqë premtuesit po "detyrohen" të fyejnë me qëllim që t'i ikin asaj se çfarë kanë premtuar, e që duhet realizuar.

Vlen të theksojmë se është mjaft brengosës fakti se në shtypin ditor është përdorur një gjuhë tejet e rëndë dhe fyese ndaj komunitetit musliman. Kjo është diçka e turpshme dhe aspak e drejtë nga ana e atyre të cilët e bëjnë një gjë të tillë.

Nëse tentohet që veprat të bëhen sa për sy e faqe dhe shikohet nga njerëzit që të mashtrohen ata dhe të mendohet mirë për ta (premtuesit) dhe nuk shikohet nga drejtësia e sinqeriteti, themi se nuk jemi nga ata të cilëve u hidhet hi syve e u lyhen buzët e heshtin.

Një verset kuranor thotë: "Mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut." Sigurisht se do mendohet rreth asaj se ne jetojmë veç nga shpresa, pa i kushtuar rëndësi edhe aq punës… ose edhe siç po ndodh … gumëzhijnë një, dy a tre ditë rreth një projekti, çështje dhe sikur e kalojnë në harresë pastaj. Kësaj radhe nuk ka të ndalur derisa të arrihen të gjitha të drejtat elementare të cilat i takojnë komunitetit musliman. Vërtet është për të mos e humbur shpresën nga Zoti që një ditë do të këndelleni sa nuk është bërë tepër vonë, madje as mos të harroni se këta pushtetarë, të cilët po i zvarrisin realizimet e premtimeve të tyre, herë në këtë muaj e herë në këtë vend, nuk kanë ardhur vetë në këto vende e as nuk i ka sjellë lejleku, por vota edhe e besimtarëve muslimanë. Pra kërkohet që të vetëdijesohet ajo pjesë e cila nuk është e paktë në numër, që të shohin se çfarë kanë vepruar duke menduar se po veprojnë drejt, e që përmes kësaj po i përmbysin ata të cilët para më shumë se një dekade e kanë kërkuar këtë gjë, por mjerisht as nuk janë ndalur t'i dëgjojnë, e as nuk kanë bashkëbiseduar me ta. Megjithatë nuk duhet që në asnjë moment e as mënyrë të humbasim shpresën, por t'i përkrahim ata të cilët në një mënyrë a tjetër po përpiqen që të drejtën dhe të vërtetën e komunitetit musliman ta çojnë përpara dhe t'i marrin nga ata realizimet e premtimeve të dhëna për të drejtat elementare që na takojnë, sikurse i kanë të gjitha vendet e tjera të zhvilluara, qoftë edhe nga vendet e krishtera, por që i respektojnë të drejtat e të gjithëve, pa marrë parasysh religjionin. ■

Kur përzihen

Debatet le të zhvillohen me një kulturë të atillë që të flasim vetëm për atë që kemi njohuri e dije ngase shkelim parimet morale dhe i japim mundësi tjetrit të na thotë se "nuk po dike gjë, qenke i paditur". Të mundohemi që të kontribuojmë në të mirën e shoqërisë dhe ta dërgojmë përpara atë, ngase edhe ky është qëllimi i njeriut në tokë.

Osman D. GASHI

Muaji qershor pasoi me kritika dhe debate të ashpra për shkak të disa besimtarëve muslimanë që protestuan për të kërkuar një xhami të madhe në Prishtinë për të pasur një hapësirë ku do të kryenin faljen, e cila është e drejtë themelore e individit në çdo shoqëri sekulare, laike ose çfarëdo qoftë ajo. Kjo kërkesë është një e drejtë e tyre legjitime. Kjo kërkesë që sa vite është bërë edhe nga Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës në mënyrë që besimtarët të mos falen në shi e borë kur është ftohtë dhe në diellin përcëllues kur është nxehtë.

Në këtë debat u inkuadruan shumë komentues dhe profesionistë që e parashihnin këtë situatë të krijuar nga këndvështrimi i tyre. Zaten kur diskutohet dhe debatohet për tema fetare e sidomos në lidhje me fenë islame ashpërsohet gjuha dhe kritikat janë vend e pavend e për fat të keq inkuadrohen edhe njerëz që nuk e njohin sa duhet Islamin dhe përziejnë programin hyjnor me veprimet e njerëzve që e quajnë veten musliman. Fillimisht duhet të bëhet ky dallim: nuk janë të njëjtë Islami -- program i zbritur nga Zoti i plotfuqishëm për t'i udhëzuar njerëzit në rrugën e drejtë -- dhe muslimanët -- pasues ose praktikues të këtij programi hyjnor -- që asnjëherë nuk e zbatojnë 100% këtë program, ngase është e pamundur.

Feja, nga aspekti terminologjik, definohet në shumë mënyra. Por, nga aspekti semantik, ajo ka të bëjë me shpirtin ngase është bindje dhe nënshtrim i plotë ndaj diçkaje që besohet. Pra, feja ka të bëjë me anën emocionale kryesisht, por pa i përjashtuar edhe ato praktike. Emocionet, duke qenë prezent në manifestimin e fesë, bëjnë që kur vjen fjala te kritikat, debatet ose mendimet ndryshe, reagimet të jenë të pashmangshme, verbale ose jo verbale qofshin ato.

Këshilltarë që e shohin të bardhën si të zezë

Debatet polarizuese prezente në media të shtypura dhe elektronike në të shumtën e rasteve ishin të ashpra dhe me një gjuhë që nxirrte në pah mosnjohurinë e komentuesve, sidomos të atyre që sulmonin dhe etiketonin Islamin, përfshirë këtu edhe grupin protestues që i vishnin emra si radikalistë, vehabistë e çfarëdo që u vinte në mendje. Kjo panjohuri vinte për dy arsye: ose këta komentues e debatues -- përfshirë këtu edhe një këshilltar të kryeministrit të Kosovës -- nuk e njohin sa duhet Islamin, ose e përziejnë Islamin me veprimet e njerëzve. Islami si program hyjnor, si fe, është i njëjtë si në lindje ashtu edhe në perëndim, si në hemisferën veriore po ashtu edhe në atë jugore. Veprimet e njerëzve (muslimanëve) janë ato që dallojnë nga vendi në vend, nga kultura në kulturë. Kur kihet parasysh kjo gjë, themi se debatuesit dhe komentuesit që sulmojnë fenë islame e kanë gabim, ngase nuk ka Islam modern, tradicionalist, liberal, radikal, të lindjes, të perëndimit, të



gjërat...

shkretëtirës... Ka vetëm Islam (fe islame) dhe muslimanë që në bazë të interpretimit dhe kuptimit të Islamit veprojnë dhe praktikojnë Islamin në jetën e tyre, kush më shumë e kush më pak.

Në një debat në televizionin publik të Kosovës, një prej këshilltarëve të kryeministrit, njëherësh edhe asistent në Universitetin publik të Prishtinës, deklaroi se Islami është fe që i përket të kaluarës dhe nuk ka vend për të në kohën bashkëkohore dhe Islami nuk duhet të jetë prenzent në sferën publike, kush do që të praktikojë fenë le ta bëjë në shtëpinë e tij. Vaj halli për shoqërinë tonë po pati kryeministri i vendit tërë këshilltarët e këtillë, ngase do të na humbiste udha në oborr! Pse po e them këtë? Ngase këshilltarët e këtillë do ta shihnin të bardhën si të zezë dhe e kundërta. Sot, në kohën në të cilën po jetojmë, shumica e shkencëtarëve e marrin Kuranin -- librin e zbritur nga Zoti i plotfuqishëm, i cili është baza kryesore e fesë islame -- si kushtetutën e tyre për t'i udhëzuar drejt shtigjeve të reja zbuluese dhe arritjeve shkencore që na e përmirësojnë jetën tonë në përgjithësi. Si mundet që feja islame t'i përkasë të kaluarës nëse shkencëtarët vazhdimisht merren me të??? Ky ishte vetëm një segment argumentues. Aspekti tjetër është te manifestimi publik i fesë, ose çfarëdo bindje tjetër që kanë njerëzit. Është e drejtë legjitime që njerëzit ta mbajnë në vete bindjen e tyren dhe ta shprehin publikisht pa e cenuar ose shkelur bindjen e tjetrit. Manifestimi i fesë, i të qenit musliman, mund të bëhet publikisht dhe nuk ka kush që mund ta mohojë, ngase është e garantuar me të gjitha të drejtat që ekzistojnë. Sa qesharake do të ishte sikur t'i themi dikujt që nëse je i bindur që je shqiptar mos e shfaq këtë bindje publikisht, por mbaje në vete. Pra, si mundet një "këshilltar" dhe "asistent i universitetit publik" të këshillojë dikë që bindjen e tij mos ta bëjë publike? No comment!

INDEKS
www.indeksonline.net
Shpejt. Origjinal.

Shpërble vetveten
Pusho me VAS

BALLINA | LAJME | SPORT | SHOWBIZ | TEC

Këshilltari i Thaçit fyen muslimanët

11.07.2011/11:13 - E Hënë   Shpërndaje 32

Lëvizja BASHKOHU që kërkon ndërtimin e një xhamie në qendër të Prishtinës ka dal me një kërkesë tjetër për kryeministrin Hashim Thaci: Ta shkarkoj këshilltarin politik, Blerim Latifin për fyerjen që i ka bërë Kuranit. Në një komunikatë për media i kërkohet kryeministrit të veproj menjëherë.

Blerim Latifi, keshilltar i kryeministrit



Mediat të raportojnë me përgjegjësi

Këto debate e reagime të ashpra dhe emocionale që bëjnë komentuesit e ndryshëm kundrejt Islamit sinjalizojnë edhe degradimin moral dhe padituriné që e ka pllakosur shoqërinë tonë. Është e pamoralshme që të debatosh për gjëra për të cilat nuk ke njohuri ose kur e përzien shapin me sheqerin. Pastaj, është e çuditshme kur mediat me informacionin dhe transmetimet e tyre hedhin benzinë në zjarr, duke iu dhënë hapësirë përmbajtjeve që reflektojnë negativitet dhe që dërgojnë ujë në mulli të huaj. Rasti më i çuditshëm ishte kur mediat raportuan kinse shtypi amerikan ka shkruar se protestat për xhami që janë mbajtur në Prishtinë e paskan hedhur poshtë përkushtimin amerikan në Kosovë. Në raport nuk theksohet e as përmendet se cilat gazeta, revista ose çfarëdo media qofshin ato, paskan shkruar një gjë të tillë. Një sjellje e tillë e papërgjegjshme e mediave në Kosovë ndikon që ato ta humbasin besueshmërinë e tyre karshi recipientëve të tyre, ngase raportojnë përmbajtje të paverifikuar dhe përçarëse, ku përmes raportimeve të tyre e hutojnë opinionin dhe mundohen të bëjnë presion të panevojshëm.

Për fund...

Kushdo që debaton për fenë duhet ta ketë të qartë një gjë: Feja dhe pasuesit (praktikuesit) e saj janë dy gjëra të ndryshme. Nuk bën të përzihen këtë dy gjëra ngase bëhet puna mishmash. Zgjedhja e njeriut për të praktikuar fenë ose jo është liri që e gëzon gjithsecili, por nuk do të thotë që kjo gjë të imponohet. Debatet le të zhvillohen me një kulturë të atillë që të flasim vetëm për atë që kemi njohuri e dije, ngase shkelim parimet morale dhe i japim mundësi tjetrit të na thotë se "nuk po dike gjë, qenke i paditur". Të mundohemi që të kontribuojmë në të mirën e shoqërisë dhe ta dërgojmë përpara atë, ngase ky edhe është qëllimi i njeriut në tokë. ■

Nga viti 2013 do të kemi Gjykatë Themelore, Gjykatë të Apelit dhe Gjykatë Supreme

RREGULLORJA PËR ORGANIZIMIN E GJYKATAVE E GATSHME PËR SHTATOR

Sistemi Gjyqësor i Kosovës nga viti i ardhshëm do të organizohet në tri shkallë, atë të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Me një vendim të tillë, që është paraparë me Ligjin për Gjykata i Republikës së Kosovës, nuk do të ketë më Gjykata për Kundërvajtje, Gjykata Komunale, Gjykata të Qarkut dhe Gjykata Ekonomike. Pra, nga viti 2013 dhe më tutje, në Kosovë nuk do të aplikohet Ligji mbi Gjykatat e Rregullta të ish-Jugosllavisë

Qëndresë MUSTAFA

Sistemi Gjyqësor i Kosovës nga viti i ardhshëm do të organizohet në tri shkallë, atë të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Me një vendim të tillë, që është paraparë me Ligjin për Gjykata të Republikës së Kosovës, nuk do të ketë më Gjykata për Kundërvajtje, Gjykata Komunale, Gjykata të Qarkut dhe Gjykata Ekonomike. Pra, nga viti 2013 dhe më tutje, në Kosovë nuk do të aplikohet Ligji mbi Gjykatat e Rregullta të ish-Jugosllavisë.

Kadri Begolli, kryetar i grupit punues për hartimin e rregullores së brendshme të gjykatave, ka thënë se kjo rregullore, pas miratimit, do t'i dërgohet Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

"Ligji për Gjykata parasheh reformimin e gjykatave, andaj grupi punues është duke hartuar rregulloren për organizimin e brendshëm të gjykatave. Ky grup është duke hartuar rregulloren për ndryshime, ku pas përfundimit do t'i dërgohet për miratim Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK)", - ka thënë Begolli.

Ndër të tjerash, Begolli ka thënë se kjo rregullore do të jetë e gatshme deri në shtator të këtij viti, ndërsa sipas tij, në janar të vitit 2013, KGJK-ja duhet t'i bëjë ndryshimet në emërtimin e gjykatave dhe funksionin e tyre.

"Nëse miratohet rregullorja në shtator, ajo mund të hyjë në fuqi menjëherë, por kjo nuk do të thotë që ligji do të fillojë të zbatohet deri në janar 2013. Ligji e obligon KGJK-në që deri në janar të vitit 2013 të bëjë këto ndryshime në emërtimin e gjykatave dhe funksionimin e tyre", - është shprehur Begolli.

Ndërkaq kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovë, Enver Peci, ka thënë se një problem tjetër në sistemin e drejtësisë është edhe mungesa e gjyqtarëve, ndërsa ka treguar se një gjyqtar mesatarisht ka 2 mijë lëndë.

"Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me qëllim të koordinimit të punëve dhe rritjes së besimit te qytetarët, ka hartuar strategjinë për zgjidhjen e lëndëve bazë, ku qëllim i gjithë kësaj është që lëndët të procedohen ashtu siç kanë arritur në gjykatë", - është shprehur Peci.


Lëndët e pazgjidhura nëpër gjykata

Gjykatat e Qarkut do të shndërrohen në Gjykata Themelore. Shtatë Gjykata Themelore do të jenë me seli në territorin e Prishtinës, Gjilanit, Gjakovës, Prizrenit, Pejës, Ferizajt dhe Mitrovicës. Çështjet administrative dhe ekonomike janë kompetencë ekskluzive të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Gjykata Themelore e Prishtinës do të përbëhet nga katër departamente: Departamenti për Çështjet Ekonomike, Departamenti për Çështjet Administrative, Departamenti për Krimet e Rënda dhe departamenti i Përgjithshëm. Kurse Gjykatat Themelore të rajoneve të tjera kanë vetëm dy departamentet e fundit: atë për Krime të Rënda dhe të Përgjithshëm. Gjykata e Apelit themelohet si gjykatë e shkallës së dytë dhe do të shqyrtojë të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatës Themelore, si dhe do të vendosë për konfliktin e juridiksionit ndërmjet Gjykatave Themelore dhe për çështje të tjera të parapara me ligj. Ndërsa Gjykata Supreme është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë dhe ka juridiksion në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Ai ka premtuar se gjatë reformimit nuk do të emërohet asnjë gjykatës pa u hetuar mirë e kaluara e tij.

"KGJK-ja mendon që në të ardhmen të mos emërohet asnjë gjykatës pa u hetuar mirë e kaluara e tij. Prandaj, sistemi gjyqësor është në reformim e sipër dhe për të ardhur te një sistem me të vërtetë i besueshëm duhet kohë, pasi siç e dimë vetëm procesi i riemërimit të gjyqtarëve i ka marrë së paku dy vjet", - ka deklaruar Peci. ■



Gjatë një konference për ligjin e punës organizuar nga Unioni i Gazetarëve të Kosovës

Ligji i punës (nuk) zbatohet

Lulzim AHMETI & Besnik BOLETINI

Ligji i Punës është një nga ligjet që ka bërë më së shumti bujë në opinion. Për miratimin e këtij ligji ka pasur shumë presione nga punëtorët, sindikatat e punëtorëve dhe nga shoqëria civile. Zyrtarë nga Inspektorati i Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) kanë thënë se Ligji i Punës është duke u zbatuar më mirë në kompanitë publike, por jo në nivelet e dëshiruara. Edhe pas miratimit të këtij ligji aq të rëndësishëm dhe të shumëkërkuar ende po shkelen të drejtat e punëtorëve, sidomos në sektorin e ndërtimtarisë, por edhe në sektorë të tjerë.

Shefi i Inspektoratit të Punës, Basri Ibrahimi, ka treguar se edhe në ndërmarrjet publike ka shkelje të ndryshme, madje sipas tij, ka edhe punëtorë pa kontrata. Por, siç thotë ai në krahasim me ndërmarrjet private, në ndërmarrjet publike Ligji i Punës zbatohet shumë më mirë, por jo në nivelin e dëshiruar". Sipas tij, inspektimet do të vazhdojnë nga inspektorët e punës, të cilët do të bëjnë që Ligji i Punës të zbatohet në masë sa më të madhe dhe në mënyrë që të drejtat e punëtorëve të mos shkelen. Ibrahimi ka thënë se masat e ndërmarra janë të ndryshme, si vërejtje me shkrim, deri te gjoba me të holla. Kryeinspektori Bastri Ibrahimi ka thënë se nëse nuk bëhet ekzekutimi i të gjitha gjobave, atëherë punëdhënësit mund të ndihen të paprekshëm nga shteti dhe të vazhdojnë të bëjnë shkelje të tjera.

Instituti GAP ka bërë një monitorim për të parë se sa po zbatohet ky ligj. Sipas këtij monitorimi, ligji në fjalë nuk po zbatohet si duhet. Jeton Ahmeti, anëtar i këtij instituti, ka thënë për revistën "Paqja" se me gjithë efektet e para pozitive, disa nene të këtij ligji, sikurse ai i pushimit të lehonisë, kanë sjellë probleme të para sa i përket zbatimit të ligjit. Mosdeklarimi i punëtorëve është shkelje e ligjit dhe e të drejtës që paraqet shkelje ligjore dhe nuk duhet të tolerohet. Ka biznese që, sipas Inspektoratit të Punës, nuk respektojnë orarin e punës si duhet, sikurse sektori i hotelerisë ku punëtorët punojnë më shumë se 8 orë në ditë, restorantet dhe lokalet, marketet e mëdha, etj", - thotë Ahmeti, duke shtuar se disa nene të këtij ligji do të kenë vështirësi për t'u zbatuar, sidomos në sektorin e ndërtimtarisë, sepse ndërtimtaria në Kosovë është një punë sezonale.

Edhe nënkryetari i Konfederatës së Sindikatave 'Lira e Kosovës' (KSLK), Ali Dragusha, është shprehur i pakënaqur me zbatimin e këtij ligji. "Shkeljet janë të natyrave të ndryshme, duke filluar nga kontratat e punës, orari i stërzgjatur, pagat e ulëta etj. Punëdhënësit po i eksploatojnë punëtorët, por duke pasur parasysh gjendjen e vështirë ekonomike dhe shkallën e lartë të papunësisë, punëtorët shpesh nuk i paraqesin rastet në të cilat shkelen të drejtat e tyre", - ka theksuar Dragusha.

Sektori publik qëndron më mirë

Zëdhënësi i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Viktor Buzhala, ka thënë se që nga hyrja e Ligjit të Punës në fillim të këtij viti në fuqi, KEK-u është duke e zbatuar në përpikëri. Edhe zëdhënësi i Postë Telekomit të Kosovës (PTK), Menduh Abazi ka theksuar se në PTK, Ligji i Punës aplikohet në tërësi që nga dita kur ka hyrë në fuqi.

Ndjeshmëria e ligjit

Muhamet Sadiku, profesor i ekonomisë, ka thënë se është mirë që kemi një ligj të tillë. Edhe ky ligj e ndan fatin me mënyrën e implementimit me ligjet e tjera. Sipas tij, sa u përket ligjeve, jemi Evropë, kurse për implementim, jemi larg. "Ligji i punës bën pjesë në ligjet me sensitive, ngase afekton shumë njerëz. Mbetet që ministria dhe qeveria të formojnë kapacitete inspektuese dhe ta ashpërsojnë regjimin e gjobave për moszbatuesit. Dihet se ligjet janë të sfiduara nga shumë faktorë. Vullneti politik mbetet tejet i rëndësishëm", - ka thënë njohësi i çështjeve ekonomike Muhamet Sadiku.

Disa komuna nuk kanë inspektorë!

Jeton Ahmeti, nga instituti GAP, tha se shumë biznese vazhdojnë të mos nënshkruajnë kontrata me punëtorët e tyre dhe se një arsye për mosrespektimin e disa prej neneve të këtij ligji është tendenca për t'i ikur tatimit dhe se kjo bën që disa biznese të mëdha të mos e zbulojnë asnjëherë numrin e vërtetë të punëtorëve, sepse ka nga punëtorët që nuk kanë fare kontrata dhe paguhen në baza ditore. Ai shtoi se pengesë për zbatimin e këtij ligji është edhe numri i vogël i inspektorëve. "Përveç kryeinspektorit që ka një staf prej 4 vetash, në Kosovë janë në total 51 inspektorë, të shpërndarë nëpër komuna. Ky numër i inspektorëve është shumë i vogël për të mbuluar të gjitha bizneset që operojnë në Kosovë. Shtrirja e inspektorëve nëpër komuna gjithashtu nuk është në nivelin e duhur, ngase sot, kur Kosova ka 37 komuna, ende ka komuna që nuk kanë asnjë inspektor të vetëm, përfshirë edhe dy komuna jo edhe aq të vogla si Suhareka dhe Istogu. Disa nga komunat e dala pas procesit të decentralizimit, po ashtu, kanë mungesë inspektorësh", - theksoi ai.

Ahmeti tha se duke marrë parasysh këtë fakt është e domosdoshme që të shtohet numri i inspektorëve në terren. "Inspektorati i Punës duhet të shtojë aktivitetin e tij, të jetë sa më prezent në terren, të informojë punëtorët për të drejtën e tyre për të paraqitur ankesa në rast të shkeljes së ligjit nga ana e punëdhënësit dhe të informojë punëdhënësit hollësisht për obligimet e tyre ligjore ndaj punëtorëve, duke ua rikujtuar se mospërmbushja e obligimeve ligjore sanksionohet me gjobat e parapara me ligj", - u shpreh Ahmeti.

Sipas Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë janë të regjistruara 106 mijë e 555 biznese. Në bazë të Konventës së ILO-s, në bazë të së cilës edhe është themeluar Inspektorati i Punës, inspektorët e punës duhet ta inspektojnë një biznes sa herë që ata e shohin të domosdoshme. Por, numri i vogël i inspektorëve pamundëson që çdo biznes të vizitohet një herë në vit. Nëse inspektorët duhet të vizitojnë çdo biznes të paktën një herë në vit, atëherë 51 inspektorët e punës për të vizituar totalin prej 106 mijë e 555 biznese, i bie që mesatarisht secili të inspektojë nga 2 mijë e 89 biznese në vit, gjë që është e pamundur.

Gjithashtu, edhe Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), ka bërë një monitorim se sa po zbatohet Ligji i Punës dhe cilat janë pengesat në zbatimin e këtij ligji. Drejtoresha e QPA-së, Shqipe Pantina, prezantoi problemet kryesore të dala nga procesi i monitorimit dhe hulumtimi i kryer me punëtorët e sektorit publik, privat dhe joqeveritar. Ajo ka thënë se nga ky hulumtim ka dalë se një numër i madh i të punësuarve, ndonëse kanë kontrata me shkrim, ato nuk janë në përputhje me Ligjin e Punës. Sipas këtij hulumtimi, në shumicën e rasteve, orari i punës është deri në 60 orë në javë, nuk paguhen orët shtesë, pushimi vjetor jepet pa pagesë ose në rastet më të mira 10 ditë në vit, ndërsa siguria në punë nuk është e rregulluar pothuajse fare. Ajo, po ashtu, theksoi shqetësimin për moszbatimin e të drejtës së pushimit të lehonisë dhe tendencën për mosvazhdimin e kontratave nga punëdhënësit privatë për gratë shtatzëna.



MPMS-ja e ka prioritet vetëdijesimin e punëdhënësve

Musa Demiri, zyrtar për informim në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka thënë për revistën "Paqja" se Ligji i Punës ka gjetur zbatim më të mirë sesa Ligji Themelor i Punës për shumë arsye: publiciteti i duhur që i është dhënë nga mediet,vetëdijesimi i grupeve të interesit (punëdhënësit dhe punëmarrësit) për zbatimin e këtij ligji. Ai tha se Inspektorati i Punës në baza ditore inspekton kompani të ndryshme, pothuajse në të gjitha komunat, për të verifikuar sesa po zbatohet Ligji i Punës. Sipas tij, ky inspektorat ka vërejtur disa parregullsi në zbatimin e ligjit në fjalë. Sipas tij, një gjë shqetësuese dhe që po paraqet vështirësi në zbatimin e ligjit është numri i vogël i inspektorëve. "Në kuadër të MPMS-së vepron Inspektorati i Punës, i cili merret me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Punës. Inspektorët e Punës çdo ditë janë në terren për të inspektuar zbatimin e Ligjit të Punës. Por, nuk mund të themi se çdo gjë është në rregull dhe ligji po zbatohet plotësisht. Problemet më të mëdha janë: Orari më i gjatë se sa është paraparë me ligj, hezitimi i punësimit të femrave (për shkak të pushimit të lehonisë) dhe pushimet javore. Ndërsa, Inspektorati i Punës ka gjithsej 52 inspektorë që mbulojnë tërë territorin e Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh numrin e madh të bizneseve dhe obligimin ligjor, që së paku njëherë në vit të inspektohet çdo kom-



pani, rezulton që numri i inspektorëve është i vogël. Për të qenë më efikas dhe më efektivë në mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji kërkohet një numër më i madh i inspektorëve. Inspektorët aktualë janë profesionalisht të ngritur, por të pamjaftueshëm", -shtoi Demiri.

Ndëshkimet

Ligji i Punës parasheh dënime të mëdha për ata që nuk e respektojnë. Bazuar në Ligjin e Punës, ndëshkimet arrijnë deri në 10 mijë euro. Nëse bëhet shkelje ndaj personave të mitur është dyfishi i kësaj vlere, kurse për diskriminimin në punë, në çfarëdo forme që mund të paraqitet, parashihet gjobë deri në 30 mijë euro. Kurse në bazë të Ligjit për Sigurinë në Punë, në rast të lëndimeve, vdekjes së punëtorëve, apo nëse pronarët nuk iu përmbahen kritereve të sigurisë, gjobat janë deri në 35 mijë euro. Për zbatimin e Ligjit të Punës gjatë vitit 2011 janë paraparë 4.8 milionë euro nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Musa Demiri u shpreh se qëllimi primar nuk është që të gjobiten punëdhënësit, por që ata të vetëdijesohen për ta respektuar këtë ligj. "Shkelësit e këtij ligji ballafaqohen me rrezikun të dënohen deri në 10 mijë euro për çdo shkelje. Për shkeljen e të drejtave të të punësuarve të grupmoshës 15-18 vjet deri në 20 mijë euro, ndërsa për diskriminim deri në 30 mijë euro. Nga sfera, të cilën e rregullon Ligji i Punës, ka pasur gjoba kryesisht në muajin qershor. Dihet se ky ligj ka hyrë në fuqi këtë vit dhe ne më shumë i kemi këshilluar punëdhënësit si të zbatohet ky ligj, sepse punëdhënësit nuk kanë qenë të njoftuar mirë me këtë ligj. Gjithashtu, muaji prill ka qenë muaji i "Amnistisë" që ka pasur për qëllim që t'u jepet edhe pak kohë për vetëdijesim dhe besojmë se ka pasur rezultat. Ne jemi të vetëdijshëm se opinioni kërkon që të jemi më të ashpër, të shqiptojmë më shumë gjoba dhe ato të jenë më të larta, por ne mendojmë se qasja jonë po jep rezultate dhe vetëdijesimi gjithnjë është në ngritje. Gjithmonë e kemi theksuar se gjoba është mjeti i fundit, e jo qëllim në vetvete, sepse ne nuk e kemi qëllim në vetvete gjobën, por t'i edukojmë punëdhënësit që ta zbatojnë ligjin, d.m.th të respektojnë të drejtat e punëtorëve të parapara me ligj", - u shpreh Demiri.

Domosdoshmëria e zbatimit të ligjit

Flora Brovina, anëtare e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në Kuvendin e Kosovës, në një prononcim për revistën "Paqja", ka thënë se Ligji i Punës duhet që të zbatohet plotësisht. Ajo tha se ky komision ka pasur takime me disa organizata që kanë monitoruar zbatimin e këtij ligji, ndërsa tha se së shpejti edhe Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale do të marrë vendim që ta monitorojë këtë ligj. "Ligji i Punës kërkon pak kohë për t'u zbatuar plotësisht, pasi që është një kohë e shkurtër kur është miratuar. Ne, si Komision për Punë dhe Mirëqenie Sociale, kemi pasur disa takime me disa organizata që kanë bërë monitorimin e zbatimit të Ligjit të Punës. Ky ligj duhet të zbatohet si i tërë, sidomos te pushimi i lehonisë, kontratat e punës etj. Ndërsa sa i përket monitorimit, besoj që së shpejti dhe ne si komision parlamentar do të marrim vendim për monitorimin e këtij ligji", - tha Brovina.

Nuk kanë siguri në punë, punojnë edhe të dielën

Shumica e punëtorëve që punojnë në ndërtimtari dhe punë krahu në përgjithësi, nuk gëzojnë të drejtat që ua garanton Ligji i Punës. Ganiu, (që nuk dëshironte të jepte identitetin për shkak të rrezikut për të mbetur pa punë) një punëtor që punon për një nga kompanitë ndërtimore në Prishtinë, tha se punon edhe gjatë vikendeve. "Ne përveç që punojmë nga 10 orë e më shumë, punojmë edhe të dielave, sepse shefi merr punë shumë dhe për një afat të caktuar duhet që t'i kryejë dhe kështu ne duhet të punojmë shpesh pa asnjë ditë pushim", - tha ai. Ndërsa Brahimi një punëtor tjetër që punon në ndërtimtari, tha për revistën se shqetësohet më së shumti për sigurinë në punë. Ai tha se nëse punëtorët e firmës ku ai punon lëndohen në punë, përveç dëmtimeve fizike duhet që të paguajnë edhe shpenzimet e shërimit. "Mua më ka ndodhur vitin e kaluar që të rrëzohem dhe më është dashtë që të paguaj spitalin vetë dhe gjatë asaj kohe kam mbetur pa të ardhura. Këtë fat e kanë pasur edhe disa kolegë të mi. Kjo ka ndodhur sepse kemi punuar pa kontrata dhe punëdhënësi nuk ka dashur të dëgjojë për këtë çështje. As tani nuk kemi kontrata, pra nuk kemi kurrfarë sigurimi, por shpresojmë që do të na i bëjnë kontratat me këtë ligjin e ri", - u shpreh ai. ■

Intervistë me Musa Dragushën

Avokatët gjobiten për shkelje të sistemit disiplinor

Qëndresë MUSTAFA



Musa Dragusha

I pari i avokatëve të Kosovës ka thënë se shoqëria kosovare përballet me sfidën më të madhe në historinë e vet: ndërtimin e rendit demokratik dhe vendosjen e sundimit të ligjit, që sipas tij janë përcaktuese të së ardhmes së saj politike. Ndër të tjerash i pari i avokatëve ka thënë se institucioni që ai drejton ka mision të përhershëm dhe standard të konsoliduar në përpjekje për të ruajtur, promovuar dhe avancuar idealet e drejtësisë dhe dedikimin e profesionit ligjor. Për më gjerë flet në intervistën për revistën "Paqja" kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), Musa Dragusha.

PAQJA: ***Z. Dragusha, cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohet Oda e Avokatëve të Kosovës?***

Dragusha: Në çdo sistem juridik, shoqatat e avokatëve luajnë rol themelor në funksionimin e sistemit juridik, duke ofruar përfitime të rëndësishme për anëtarësinë, profesionin dhe për komunitetin. Rol të veçantë këto shoqata luajnë në mbrojtjen dhe përforcimin e administrimit të drejtësisë, duke shtrirë kuptimin dhe zbatimin e ligjit dhe të institucioneve, si dhe duke identifikuar përpjekjet për ndryshimet e nevojshme ligjore. Roli themelor, të cilin Oda e ka në funksionimin e profesionit të drejtësisë, ia parashtron asaj një nga qëllimet kryesore të misionit: të nxitë një qasje sa më të plotë dhe të barabartë të përfaqësimit ligjor për të gjithë personat, pa marrë parasysh kushtet ekonomike dhe sociale. Këto përpjekje do të përfshijnë veçanërisht pakicat, gratë dhe personat me të meta. Oda ka mision të përhershëm dhe standard të konsoliduar përpjekjet për të ruajtur, promovuar dhe avancuar idealet e drejtësisë dhe dedikimin e profesionit ligjor shërbimit publik. Oda i konsideron synime të përhershme angazhimet për ruajtjen e pavarësisë së profesionit ligjor dhe pushtetit gjyqësor si themele të shoqërisë së lirë e demokratike. Hulumtimet objektive kanë identifikuar se numri i tanishëm i avokatëve të licencuar nuk është i mjaftueshëm për t'i plotësuar në mënyrë adekuate kërkesat aktuale për shërbimet ligjore të tyre.

PAQJA: ***Z. Dragusha kryesisht sa avokatë ka Kosova, të rregullt dhe ex-officio (sipas detyrës zyrtare)?***

Dragusha: Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) me sistemin e ri të licencimit të avokatëve, në radhët e saj numëron rreth 575 avokatë. OAK brenda vetes, po ashtu, ka përfshirë dhe avokatë të komuniteteve të tjera, si të komunitetit serb, të komunitetit turk dhe atij boshnjak. Secili avokat, anëtar i Odës, është i obliguar që të japë kontributin e vet, të angazhohet në ndihmën juridike falas, e cila financohet nga buxheti publik dhe menaxhohet nga Komisioni i Ndihmës Juridike, i vendosur me një ligj të veçantë mbi ndihmën juridike në Kosovë. Çdo person i privuar nga liria ka të drejtë në shërbimet e mbrojtësit që nga arresti e tutje dhe në qoftë se i pandehuri nuk angazhon mbrojtës, atij i caktohet 'ex officio' (avokat sipas detyrës zyrtare). Sipas Kornizës Ligjore mbi Ndihmën Juridike, OAK është e detyruar që të sigurojë listën e plotë të avokatëve nëpër qarqe, duke pasur parasysh disponimin e tyre, gatishmërinë për të shërbyer, përvojën dhe lëmin e ekspertizës. Mirëpo, në praktikën e deritashme, pranë gjykatave dhe prokurorive, një grup i ngushtë

i avokatëve gjenden vazhdimisht të angazhuar sipas detyrës zyrtare. Avokatët e caktuar angazhohen vazhdimisht, por ka edhe një numër të avokatëve që angazhohen nga gjyqtarë e prokurorë. Kjo po e vë opinionin nën dyshime për angazhimet e këtyre avokatëve, madje për më tepër kjo situatë nxit edhe shqetësime më të gjera, kurse tek avokatët e tjerë edhe reagime të vazhdueshme. Kjo edhe për shkakun se zyrtarët e zbatimit të ligjit (prokurorët e gjyqtarët) asnjëherë nuk u vënë në dispozicion të dyshuarve, të pandehurve ose të arrestuarve, listat e avokatëve, por në vend të kësaj bëjnë vetë "rekomandime". Praktikat e tilla, jo vetëm që rrisin dyshimet në sytë e publikut, por shkaktojnë edhe pakënaqësi te shumica e avokatëve, si dhe nxisin dyshime të thella. Kjo praktikë duhet të ndërpritet menjëherë nën masat urgjente dhe në vend të kësaj duhet vendosur instrumenti ligjor lidhur me angazhimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare.

PAQJA: ***Z. Dragusha, në OAK a ka edhe avokatë nga komunitetet që jetojnë dhe veprojnë në Kosovë?***

Dragusha: Shumica e avokatëve punojnë në shtatë qytetet më të mëdha të Kosovës, kurse vetëm një numër i vogël i kanë zyrat e tyre në qytete të vogla. Përveç kësaj, numri i avokatëve nga radhët e pakicave është shumë i vogël, d.m.th vetëm rreth pesëmbëdhjetë avokatë janë pjesëtarë të grupeve të pakicave. Komunitetet e vogla nuk shërbehen sa duhet për shkak të izolimit dhe lirisë së kufizuar të lëvizjes së tyre, si dhe pengesave shoqërore e psikologjike për të komunikuar me avokatët nga radhët e grupeve të tjera etnike. Po kështu, edhe numri i avokatëve nga radhët e femrave nuk është i kënaqshëm.

PAQJA: ***Z. Dragusha, a ka raste kur avokatët nuk e respektojnë Kodin e Etikës, nëse po, cilat janë sanksionet që ndërmerren ndaj tyre?***

Dragusha: Që prej themelimit të OAK-së ekzistonte një kornizë etike dhe një sistem i disiplinës, i konstituuar në principet e vetë disiplinimit. Pas luftës, sistemi i etikës profesionale u përmirësua dhe u ndryshua rrënjësisht, në përputhje me rrethanat dhe ambientin juridik të ndryshuar në Kosovë.

Gjoba është masa më e shpeshtë disiplinore, e cila deri më tani u është shqiptuar avokatëve për shkeljet e disiplinës së tyre. Sistemi i ri i disiplinës deri më tani ka trajtuar gjithsej 156 raste, prej të cilave 86 të mbyllura tërësisht, përderisa sistemi arkaik për tetë vite ka arritur të menaxhojë vetëm katër raste ndaj avokatëve. Megjithatë, ne, së bashku me partnerët strategjikë, jemi duke bërë përpjekje të vazhdueshme për forcimin e disiplinës në radhët e avokatëve, me masa konkrete, prandaj është themeluar Zyra e Veçantë të cilës i është ndarë staf i veçantë dhe buxhet i veçantë në mbështetje.

PAQJA: ***Z. Dragusha sa ankesa ka pasur në drejtim të avokatëve në institucionin që ju drejtoni?***

Dragusha: Natyrisht, gjithnjë ka vend për përmirësime dhe avancime, e sidomos në kushtet e përpjekjeve gjithë kosovare për forcimin e institucioneve shtetërore. Edhe OAK-ja, si pjesë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë, duhet që edhe më tutje të reformohet e të strukturohet, madje në vazhdimësi, në mënyrë që të përmbushë misionin e vet të përcaktuar me ligj. Oda e Avokatëve të Kosovës pothuajse për çdo ditë pranon ankesa për shkelje të rregullave. Këto raste trajtohen nga sistemi disiplinor. Secili prej organeve disiplinore merr vendimet për rastet e veçanta, sipas autorizimeve që ka. Çfarëdo kërkese, fletëparaqitje, ankesë ose parashtresë e paraqitur kundër avokatit ose praktikantit në avokaturë menjëherë i dorëzohet Zyrës Disiplinore, e cila pas fletëparaqitjes zhvillon procedurën disiplinore.



Megjithatë, për dallim nga e kaluara, ne tanimë kemi të përcaktuar qartë strategjitë e reformimit, riorganizimit dhe të zhvillimit përmes një Plani Strategjik. Plani synon që Avokaturën ta vendosë në qendrën e sistemit të drejtësisë, aty ku edhe e ka vendin. OAK është duke bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e performancës në mënyrë që nga një "organizatë me performacë të mërzitshme" të bëhet organizatë e cila do të kujdeset për rolin e avokatit në shoqëri, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, përmirësimin e vazhdueshëm të ligjit dhe vendosjen e sundimi të ligjit.

PAQJA: ***Z. Dragusha, a ka avokatë në OAK që kanë qenë pjesë e sistemit të drejtësisë si gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët dyshohen për kryerjen e ndonjë vepre penale apo keqpërdorim të detyrës zyrtare?***

Dragusha: Në të kaluarën nuk ka pasur kufizime për të kaluar në avokati nga ushtruesit e funksioneve të tjera të sistemit, pra gjyqtarët dhe prokurorët. Tani sistemi i ri i Licencimit, i mbështetur në ligjin e ri mbi avokatinë, ka vendosur standarde të veçanta për këtë grup. Në përgjithësi, deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të ri mbi avokatin, regjistrimi i avokatëve është bërë mbi bazat e sistemit të trashëguar, arkaik, i cili ka konsistuar thjesht në vërtetimin burokratik se kandidati i plotëson kushtet formalo -juridike. Nuk ka pasur sistem për vlerësimin e nivelit profesional dhe të denjësisë etike për këtë profesion. Ligji i ri tani i vendos edhe këto dy kategori, kështu që OAK-ja me rastin e pajisjes me licencë të një kandidati ka autoritet që të vërtetojë se a e plotëson nivelin minimal të aftësive profesionale për ushtrimin e profesionit dhe a është i denjë nga aspekti i etikës. Për dallim nga praktika e kaluar, sistemi i ri do të përfshijë një procedurë të detajuar të veprimeve për licencimin e avokatëve të rinj, e cila domosdo ka një verifikim paraprak të njohjes së rregullave të etikës dhe të përgatitjes profesionale. Oda tani përcakton standardet minimale profesionale dhe etike, të cilat do të duhej t'i plotësonte secili që pretendon licencimin. Kandidatit të cilit i është miratuar kërkesa për regjistrim është i detyruar që të vijojë Kursin Përgatitor për Avokat (KPA), që

organizohet si pjesë e Qendrës Trajnuese për Avokat (QTA). Ky program paraqet aftësimin elementar profesional, zhvillimin e shkathtësive elementare praktike dhe njohjen me rregullat e etikës profesionale. Ndërsa, në lidhje me ishbartësit e funksioneve në drejtësi: gjyqtarë e prokurorë, ligji kërkon që ata të mos kenë qenë "të pushuar" a pezulluar nga funksioni i gjyqtarit respektivisht prokurorit. Këtë verifikim OAK-ja e bën përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas një marrëveshjeje të përbashkët meqenëse ai është autoriteti për emërimin, promovimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve.

PAQJA: *Z. Dragusha, gjatë seancave kemi vërejtur që gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it, fyejnë në drejtim të avokatëve vendorë. A ka raste që keni reaguar ndaj sjelljeve të punonjësve të EULEX-it?*

Dragusha: Menjëherë, pothuajse pas vendosjes se Misionit të EULEX-it në Kosovë, janë vendosur kontaktet e para me drejtuesit e sektorit për gjyqësi. Më pas, raporti është zhvilluar në një komunikim të rregullt. Që në fillim Odën e kanë vizituar Alberto Perduca - Kryetar, Maria Civinini - kryetare e Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it dhe Guy Van Craen - zv. kryetar i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it. Ka pasuar nënshkrimi i Marrëveshjes Teknike me Zyrën e Kryetares së Gjyqtarëve të EULEX-it, me qellim të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimeve, duke ndarë praktikat më të mira në fushën e gjyqësorit në Kosovë. Jemi pajtuar që t'i ofrojmë mbështetje dhe ndihmë njëri-tjetrit në fushat e shkëmbimit të informatave, në planifikimin dhe në përgatitjen e një sistemi më të avancuar gjyqësor, duke iu përmbajtur standardeve dhe praktikave më të mira evropiane, vendosjen e takimeve të rregullta mes dy palëve; organizimin e konferencave për vetëdijesimin e komunitetit lidhur me punën e Zyrës së Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it; organizimin e tryezave të rrumbullakëta rreth zgjidhjes së çështjeve dhe problematikave të ndryshme që preokupojnë të dyja palët; ofrimin e bashkëpunimit për dosjet e humbura, të zhdukura ose të shkatërruara në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë; caktimin e një grupi të specializuar të avokatëve, të cilët do të punojnë bashkë me gjyqtarët e EULEX-



it për përfundimin e draftit për sjelljen e avokatëve gjatë gjykimit; të mbahen takime të rregullta mujore, çdo të hëne të parë të muajit vijues. Mund të ketë raste të këtilla që u referoheni, por shpresoj të jenë të izoluara, përndryshe në Zyrën e Odës nuk ka ardhur ndonjë ankese specifike sa i përket kësaj.

PAQJA: *Z. Dragusha, a është e anëtarësuar OAK-ja në ndonjë organizatë botërore që ka për qëllim mbrojtjen dhe mbështetjen e avokatëve?*

Dragusha: Po, kur në Kosovë po bëhen përpjekje gjithëpërfshirëse për njohje dhe promovim, pranimi i organizatës së avokatëve, do të thotë shumë për avancimin e profesionit të tyre, si dhe për njohje. Oda e Avokatëve të Kosovës, qysh nga viti 2002, është e angazhuar intensivisht për anëtarësim dhe promovim ndërkombëtar. Ndërsa prej vitit 2005 ajo ka synuar anëtarësimin Internacional Bar Assosiation (IBA), që është organizata më e madhe në botë e asociacioneve të avokatëve, shoqatave ligjore dhe individëve që praktikojnë ligjin në mbarë botën. Anëtarësimi do të na ofronte të gjitha beneficionet, që i kanë anëtarët në këtë organizatë. Prej atëherë, pengesë u shtrua statusi i pazgjidhur politik i vendit tonë. Njohja e Kosovës nga IBA u pranua si sinjal pozitiv, që i hapi pastaj rrugë anëtarësimit tonë. Pas komunikimeve të shpeshta me IBA-në me vota gati unanime, OAK-ja është regjistruar si anëtar me të drejta të plota. Nga ky anëtarësim, OAK-ja do të ketë mundësi të shumta lidhur me rritjen e edukimit të anëtarëve, duke shfrytëzuar mundësitë e shumta të edukimit në IBA. OAK-ja tani mund të emëroje tre përfaqësues, të cilët pastaj njihen si anëtarë të IBA-së. OAK-ja, po ashtu, ka bashkëpunime të veçanta edhe me Organizata individuale të avokatëve nga disa vende dhe përfiton shumë nga shkëmbimi i përvojave, në veçanti nga ato me traditë të gjatë dhe nga vendet me sistemet e zhvilluara juridike.

PAQJA : *Z. Dragusha, për fund cila është porosia juaj për avokatët e Kosovës?*

Dragusha: Shoqëria kosovare sot po përballet me sfidën më të madhe në historinë e vet: ndërtimi i rendit demokratik dhe vendosja e sundimit të ligjit imponohen si përcaktuese të së ardhmes së saj politike. Kërkesat e shoqërisë për krijimin e rendit ligjor demokratik, në të cilin gjykatat do të jenë të pavarura dhe të paanshme, kurse i tërë sistemi do të funksionojë në suazat ligjore, gjithnjë e më shumë paraqiten si sfida para profesionit ligjor. Praktikuesit e ligjit janë në radhët e para për t'iu përgjigjur këtyre sfidave. Në kushtet e reja është çështje imediate vendosja e standardeve demokratike, të cilat do t'i largonin organet e profesionit ligjor përfundimisht nga politika, duke i bërë të paanshme, të drejta, profesionale dhe të nënshtruara vetëm ndaj ligjit. Duke qenë të pajisur me njohuri elementare të funksionimit të sistemit nacional juridik, avokatët kanë nevojë t'i konsolidojnë dhe plotësojnë ato me njohjen e standardeve ndërkombëtare mbi institucionet juridike, funksionimin dhe punën e gjykatave, prokurorive, organeve të ndjekjes, administratës shtetërore, të drejtave të njeriut dhe qytetarit, të shërbimeve profesionale dhe praktikumit të ligjit. Arritja e standardeve demokratike duhet të paraqesë synimin kryesor të këtij profesioni. Sot në Kosovë, në rrethanat e ndryshuara, edhe avokaturës i duhet një konsolidim i drejtë dhe mirëfilltë. Ajo para së gjithash duhet të krijojë një strukturë të fortë dhe të qëndrueshme në mënyrë që të përballet me kërkesat e anëtarësisë, profesionit ligjor dhe komunitetit sepse avokatët-anëtarë, profesioni ligjor në përgjithësi dhe publiku i gjerë, përfitojnë nga organizimi i mirëfilltë dhe një rreshtim i ri i Odës, si organizatë e respektuar dhe kompetente e avokatëve kosovarë. Oda e Avokatëve të Kosovës do të ndikojë fuqishëm në pavarësinë, paanshmërinë dhe drejtësinë e gjykatave. ■

Në nderim të shtatë dëshmorëve

Ata janë të gjallë, por ne nuk e ndiejmë mënyrën e të jetuarit të tyre. Forma e jetës së tyre për ne është e panjohur, kështu na mësoi Allahu i Lartëmadhëruar. Vetëm ato familje që e kanë të paktën nga një dëshmor, arrijnë ta kuptojë më mirë se çdo kush tjetër gjallërinë e tyre

Muhamed J. KAJOLLI



Rrasa e Zogut

A nuk janë të gjallë?

Diku lart, në malet e Koshares të malësisë së Gjakovës është një lagje e dëshmorëve. Ajo lagje tuboi një pjesë të ajkës së rinisë sonë. Ata ishin më të dalluarit në familjet tona. Vëllai im nuk shihte asnjë shqiptar të keq, por shihte shqiptar të vuajtur e të robëruar që vepronin keq të shtyrë nga ..., prandaj ai kërkonte nga ne që t'i falim. Ishte hera e fundit që e pashë në fshatin Papaj dhe, në momentin që po ndahesha prej tij e shtrëngova fort, shumë fort. Nuk më tha asnjë fjalë tjetër përveç: "vëlla të luajti IMANI". Eh, sa fjalë e rëndë qe për mua, vëlla të luajti Imani.

Nuk dyshoj se secilës familje të këtyre trimave që i përkasin kësaj lagje, në një mënyrë a në një tjetër mënyrë, të mos iu kenë lënë nga një fjali që t'iu mbetet për kujtim prej tyre, mu kështu sikur fjala e vëllait tim. Ehhh, ata janë të një lagjeje prandaj, të gjithë njëlloj besojnë, mendojnë dhe amanetet u dalin nga burimi i përjetësisë. Do të më thoni se atje ka anëtarë që nuk janë shqiptarë dhe gjykimi im nuk do të ishte i saktë. Po, është e vërtetë, se atje ka një algjerian dhe një italian. Isha takuar me Muradin (*Zoti e dërgoftë në lagjen më të lartë të xhenetit*) por, në një farë mënyre, isha takuar edhe me italianin.


Iniciator: Qemajl Rexhepi (Kryetar i SHFD-së) dhe Veteranët e UÇK-së, dega Viti
Kontribuesit: Të gjithë pjesëmarrësit e familjeve të dëshmorëve të Vitisë

Derisa isha në Partesh, po bëheshim gati për të falur namazin e ikindisë, njëri prej bashkëbesimtarëve më tha: 'Le ta presim edhe Françeskon, ka pesë ditë që ka filluar të falet, si ne. Aty mësova se paskemi italianë, gjermanë, amerikanë etj. Nuk e pashë italianin me sytë e mi, por xhenazen ia fala së bashku me vëllanë tim. Ai ra shehid, mu afër vendit të vëllait tim, në Rrasë të Zogut.

Vijon në faqe 22

PAQJA
REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË


Dëshmorët nga Vitia:
Florin MALIQI,
Mejdi KORANI,
Jonuz ZEJNULLAHU,
Nijazi REXHEPI,
Remzi XHAFERI,
Safet REXHEPI,
Shabi KAJOLLI




UCK
USHTRIA
CLIRIMTARE E
KOSOVES



Vijon nga faqja 19

Ai kështu iu bashku hoxhë Jonuzit dhe Muradit...

Ata janë të gjallë, por ne nuk e ndiejmë mënyrën e të jetuarit të tyre. Forma e jetës së tyre për ne është e panjohur, kështu na mësoi Allahu i Lartëmadhëruar. Vetëm ato familje, që e kanë të paktën nga një dëshmor, arrijnë ta kuptojë më mirë se çdokush tjetër gjallërinë e tyre.

Kur ata thërrasin

Thirrjet e tyre janë të rralla, por shumë domethënëse. Kosharja gjeografikisht tani i përket komunës së Junikut, por a mund të na thonë junikasit se si arritën ta rregullojnë rrugën deri në Koshare? Jo. Ata nuk arrijnë të na thonë, por lagjja e atyre vazhdon të jetojë, punojë dhe t'i zgjerojë rrugët. Atje lart, në Rrasë të Zogut, vullnetarë nga Vitia janë mbledhur për ta zbukuruar një pjesë të asaj lagje.

Pse dhe si ndodhi!?

Përgjigjja është e paqartë për shumëkënd që nuk ka në familjen e tij një dëshmor. Mos prezenca e shumë atyre që sot kanë emra e tituj flet se ata nuk e kuptojnë gjuhën e familjarëve të dëshmorëve, edhe pse si shoqata ose institucione qeveritare mund të jenë donatorë, por thjesht, këta nuk e ndiejnë mënyrën e jetës së tyre siç e ndiejnë ata që i kanë përcjellë në momentet e fundit. U dashtë që Bac Qemali (babi i dëshmorit Safet Rexhepit) të merrte iniciativën për t'i nderuar dëshmorët e rënë në Rrasë të Zogut.

Shumëkush e përdor sot kompjuterin, po shumë, shumë pak prej tyre e kuptojnë se si funksionon ai, prandaj përgatitja dhe organizimi midis familjarëve të dëshmorëve i ngjason linqeve të rrjetit të pafund në kompjuter. Ata sikur i tubojnë vetë dëshmorët. Për këtë arsye, secilës familje nuk i duhet ftesa, sepse atë e kanë marrë në ëndërr ose një zë i ka ftuar. Askush prej tyre nuk e ndiente vështirësinë e rrugës malore deri në Rrasë të Zogut. Secili mundohej ta jepte maksimumin e vet, në rrafshim të terrenit, në vendosjen e gurëve, në vendosjen e pllakave, në pastrimin e ferrave etj. Më në fund, vendi u kurorëzua me vendosjen e Lapidarit. ■

Donatorët

Kuvendi Komunal,
Art Projekt – Flamur Hajrullahu
Shpetimi - Besim Halimi
Vinex- Jusuf Zuka
Onix- Sabri Shaqiri
Naser Shabani
Sali Avdullahu – mërgimtar
Xhelal Haxhiu dhe
Ram Shllaku



Djali i dëshmorit duke e përkujtuar babanë e tij

HUMBET LUMTURIA, SHTOHEN DIVORCET NË KOSOVË

Astrit VELIQI

Divorcet gjithnjë e me shumë po bëhen shqetësuese në shoqërinë tonë. Arsyet e një fenomeni të tillë janë të natyrave nga më të ndryshmet, si ekonomike, sociale, morale e familjare.

Por tranzicioni i sistemit shoqëror, duke nisur nga sistemi i vetë jetës dhe ndryshimeve e kërkesave të saj, por edhe evoluimet e shumta në sistemin e komunikimit dhe të teknologjisë, ka bërë që martesat në Kosovë, e sidomos pas lufte, të mos kenë shumë jetë të gjatë.

Një fat të tillë në shoqërinë sonë e përjetojnë shumë të rinj e të reja, të cilët madje nuk çajnë kokën e tyre as edhe për familjen dhe fëmijët e tyre, për të bërë atë që të gjithë ne ndoshta nuk e dëshirojmë, divorcin ose ndarjen.

Edhe pse për një martesë kosovarët janë në gjendje të bëjnë shpenzime të mëdha, vetëm për të ndërtuar një jetë dhe gëzim familjar, megjithatë, në disa raste ky gëzim i tyre nuk zgjat shumë dhe kthehet si 'bumerang'.

Burrin ia mori Evropa

Fenomenin e ndarjes e ka ende të freskët F. Hetemi, e cila madje ka lënë edhe dy fëmijët e saj, pasi që bashkëshorti i saj, pas emigrimit në botën perëndimore, nuk e ka parë të arsyeshme të kthehet më në Kosovë.

Ajo vendosi ta lërë shtëpinë e dikurshme të saj, duke i braktisur edhe dy fëmijët, pasi që bashkëshorti i saj, për të rregulluar letrat, u martua me një të huaj në Gjermani.

"Asnjëherë nuk e kam menduar se do të ndodhë një gjë e tillë, por problemet ekonomike bën që burri të ikë nga Kosova, gjoja për një jetë më të mirë", - shprehet Hetemi. Ajo me lot në sy, rrëfen për mungesën që ka për fëmijët e saj, të cilët pas braktisjes thotë se asnjëherë nuk i ka parë më sy.

Por një fat të tillë nuk e ka përjetuar vetëm ajo, por shumë të reja e të rinj në Kosovë.

Se ky fenomen tashmë është bërë mjaft i shpeshtë dhe ka pësuar gjithnjë e më shumë rritje, këtë e tregon më se miri edhe Enti i Statistikave të Kosovës.

ESK: 1453 shkurorëzime në vitin 2010

Enti i Statistikave të Kosovës (ESK), ka publikuar një raport në lidhje me kurorëzimet dhe shkurorëzimet që kanë ndodhë në vitin 2010. Nga ky raport del se në gjithsej 18 mijë e 289 kurorëzime, në vitin 2010, një numër i madh edhe janë shkurorëzuar.

"Në vitin, 2010 në Kosovë janë regjistruar 18 mijë e 289 kurorëzime, kurse 1 mijë e 453 shkurorëzime", thuhet në raportin ESK-së. Raporti i ESK-së, po ashtu, ka dhënë një informacion për shkurorëzimet që nga viti 2004 deri në vitin 2010.

Në raport jepen detaje edhe për moshën mesatare në të cilën kosovarët duan të martohen.

Thuhet se mosha mesatare e të martuarve është 29 vjeç.

Mosha e meshkujve për martesë është 27.8, kurse mosha mesatare e femrave është 27.8 vjeç.

Në këtë raport, po ashtu, janë shpallur edhe qytetet kampion të kurorëzimeve.

Prizreni kampion i kurorëzimeve në Kosovë

Sipas ESK-së, vendin e parë për martesa e zë Prizreni me 1703 kurorëzime, në vendin e dytë vjen Prishtina me 1486 kurorëzime dhe Podujeva me 1228.

Statistika për kurorëzimet dhe shkurorëzimet kanë edhe gjykatat e qarkut të Kosovës, të cilat konsiderohen edhe si njësi raportuese për shkurorëzimet. Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, sipas statistikave, prej vitit 2000 e deri në vitin 2009, numri i shkurorëzimeve ka pësuar rritje rekorde.

Sipas kësaj gjykate, në katërmujorin e fundit të vitit 2009, numri i ndarjeve është rritur deri në 200 raste, ku vetëm gjatë vitit 2010, në Prishtinë, gjykatës i janë drejtuar 22 çifte më shumë sesa në vitin 2009 për t'iu dhënë fund lidhjeve martesore.

Edhe sociologët e shpjegojnë në mënyra të ndryshme këtë fenomen. Sipas tyre, ky fenomen vjen si pasojë e tranzicionit politik e social, në të cilën gjendet shoqëria kosovare.

Pasiguria sociale prish familjen

Sociologu i ri, Faton Rashiti, vlerëson se gjendja e vështirë sociale dhe papunësia e madhe, bën që ky proces të prekë edhe familjen dhe nevojën e saj për të krijuar mirëqenien më të mirë sociale.

"Sistemi kulturor e social, nëpër të cilën po kalon shoqëria kosovare, bën që nevoja për mbijetesë të prishë edhe harmoninë mes çifteve dhe partnerëve", - thotë Rashiti.

Sipas tij, faktorët e këtij fenomeni janë të natyrave të ndryshme, por ata që e determinojnë një fakt të tillë janë mirëqenia e brishtë sociale dhe tranzicioni shoqëror e social nëpër të cilën po kalon Kosova.

Rashiti vlerëson se interferimi i këtyre faktorëve prodhon pasiguri në jetë dhe nevoja për të ndryshuar ambientin social bën që në shoqëri të rriten edhe ndarjet në familje, por edhe tradhtitë, që pashmangshëm çojnë deri te divorcet.

Si do që të jetë, me rritjen e divorceve, gjithnjë e më shumë, po humbet edhe lumturia familjare në Kosovë. Kjo duhet të brengosë gjithsecilin nga ne, por më shumë ata që përkujdesen për fatin e kësaj shoqërie. ■



Sesion përkujtimor për Hoxhë Tahsinin

Ndriçim HOXHAJ

Me rastin e 130-vjetorit të vdekjes (4 korrik 1881) së Hasan Tahsinit, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua një sesion përkujtimor. Ligjëruan studiues të figurës së tij, të cilët hodhën dritë mbi rolin e HasanTahsinit si dekan i rilindësve shqiptarë, si dhe mbi kontributin e tij në fushën e astronomisë, psikologjisë, filozofisë dhe gjuhësisë. Konferencën përkujtimore me temë: "Hoxhë Hasan – Tahsini, dijetar i shquar e atdhetar pararojë i Rilindjes Kombëtare Shqiptare" e çeli kryetari i Shoqatës Kulturore Shqiptaro –Turke "Hasan-Tahsini", Ibrahim D. Hoxha. Ai vlerësoi kontributin e Hoxhë Tahsinit në themelimin e Universitetit të parë në Stamboll, si dhe përmendi kontributin e tij në Rilindjen Shqiptare. Sesioni përkujtimor vijoi më tej me kumtesat me titull: "Pikëpamjet filozofike të hoxhë Hasan Tahsinit" nga prof. dr. Gjergj Sinani; "Ndihmesa e Hoxhë Hasan Tahsinit në lëmin e kalendarëve" nga Prof. Dr. Ibrahim Gashi; "Ndihmesa e hoxhë Hasan Tahsinit në gjuhësinë shqiptare dhe atë turke" nga Mr. Adriatik


Hasan Tahsini

Derjaj dhe më pas referoi Dr. Ramiz Zekaj, drejtori i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe të Qytetërimit Islam, i cili tha se Tahsini i përkiste asaj plejade patriotësh shqiptarë që luftuan për mësimin e gjuhës shqipe dhe përhapjen e diturive ndër shqiptarë. Ai thoshte se: "Gjuha është vegla e parë e mendimit dhe se ajo shkon paralel me përparimin mendor të njeriut". Veprimtarinë intensive, së bashku me patriotët Sami Fra-

Kush ishte Hasan Tahsini?

Hasan Tahsini lindi në fshatin Ninat të Konispolit, më 7 prill të vitit 1811. Mësimet e para i mori në medresenë më të mirë të zonës, në atë të fshatit Pandalejmon dhe më pas studioi në medresenë e Mustafa Pashë Bushatlliut në Shkodër (1822-1830). Shkollën qytetëse dhe atë fetare e vazhdoi në Janinë dhe, më pas, vazhdoi e përfundoi me sukses studimet në Medresenë "Fatih," një ndër më të njohurat e Stambollit. Përveç vlerësimit "shkëlqyeshëm" që mori në këtë shkollë, atij iu atribuua edhe epiteti "tahsin" prej dijetarit të njohur, mësuesit të tij, Mustafa efendi Vidini, që në gjuhën shqipe përkthehet "I nderuar," "I fisnikëruar," etj. Pikërisht kjo fjalë u shndërrua në mbiemër të tij. Në vitin 1857, me dekret të Sulltanit, së bashku me disa dijetarë të tjerë të zotë të kohës së tij, dërgohet në Paris, në Universitetin prestigjioz të Sorbonës për të studiuar në fakultetin e shkencave të natyrës dhe më pas të shkencave shoqërore. Hasan Tahsini zotëronte bashkë me shqipen 11 gjuhë. Tre gjuhë të lindjes: arabisht, persisht, osmanisht; greqishten e re, greqishten e vjetër e latinishten i përvetësoi në Sorbonë; frëngjishten e italishten dhe sipas të dhënave më të fundit, mendohet të ketë ditur dhe anglishten e gjermanishten. Dëshmia më e mirë për këtë janë veprat "Shkrimet e Popujve" dhe Alfabeti origjinal i tij për gjuhën shqipe. Në vitin 1869 kthehet në Stamboll dhe u emërua rektor i Universitetit, inaugurimi i të cilit u bë në fillim të vitit 1870. Por në fund të po këtij viti e shkarkojnë sepse ai paraqiti në Universitet disa kumtesa publike nga fushat e astronomisë e të filozofisë, në të cilat flitej mbi hapësirën e pafund të botës së madhe dhe mbi "botën e vogël" siç e quante veprimtarinë psikike të njeriut, gjë që shkaktoi reagime të ashpra te krerët fetarë të Stambollit. Më vonë jep mësime në një shkollë private. Biografët pohojnë se shtëpia e tij në Stamboll u shndërrua në një universitet të mirëfilltë, ku zhvillonte leksione mbi shkencat e natyrës, psikologjinë, filozofinë, mbi historinë, letërsinë, etj. Në historinë e kulturës shqiptare të Rilindjes sonë Kombëtare, Hasan Tahsini ka hyrë si një nga figurat më të shquara të shekullit të XIX-të, kurse në historinë e shkencës turke, si më i larti ndër të lartët dhe, në historinë e arsimit të lartë të Turqisë, si Rektori i parë i Universitetit të Stambollit, si ligjëruesi i parë në shkencat sociale e ato natyrore. Tahsini punoi për alfabetin shqip dhe donte ta kishte të ndryshëm nga alfabetet e gjuhëve të tjera për të treguar veçantinë karakterizuese të popullit të tij. Tahsini qe mësues i Abdylit, Naimit e Samiut, Vaso Pashës, Jani Vretos, Ismail Qemalit e Daniel Oparakut. Ai ka qenë mësues shtëpie i historianit zyrtar të famshëm osman, Hajrullah Efendiut, i ati i dramaturgut e poetit me famë osmane, Abdulhak Hamit. Në Enciklopedinë turke, Hasan Tahsini cilësohet si njeriu që futi dijet e reja të Perëndimit në Perandorinë Osmane, pra edhe në Ballkan e në Shqipëri. Ai ndërroi jetë më 4 korrik 1881. Trupi i tij u vendos në varrezat e lagjes Eren Qoj në Ysqydar, në të njëjtat varreza ku u varrosën edhe dhe tre vëllezërit Frashëri.







shëri, Naim Frashëri, Jani Vreton, Koto Hoxhin, Pashko Vasën, e gjejmë tek Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqipe në vitin 1879. Pranë kësaj shoqërie, në komisionin për hartimin e alfabetit unik të gjuhës shqipe, Tahsini paraqiti alfabetin e tij metodik. Në Enciklopedinë turke, Hasan Tahsini cilësohet si njeriu që futi dijet e reja të Perëndimit në Perandorinë Osmane, pra edhe në Ballkan e në Shqipëri. ■



NUK DO TË KISHTE INTERNET PA DIJETARIN ISLAM EL – HAVARIZMIN

Khaled SCHMIDT - Berlin

Kryeredaktori i gazetës gjermane Frankfurter Algemajne Cajtung, Wolfgang Günter Lerch, tha se bota sot nuk do ta shihte me sy internetin e as kopjuterin sikur të mos ishin teoritë dhe konceptet e themeluesit të dy shkencave, asaj të logaritmit dhe të algjebrës, si dhe autori i rregullave të shkencës së aritmetikës bashkëkohore, dijetari musliman Ebu Xhafer Muhamed bin Musa El-Havarizmij.

Lerch tha që pionierët gjermanë të shkencës së matematikës: Adam Reza, Carl Friedrich Gauss dhe Kurt Javidal i ndërtuan kërkimet e tyre shkencore mbi rezultatet që kishte arritur El-Havarizmij, të cilit i atribuohet koncepti i Havarizmit – algoritmit në matematikë dhe i cili numërohet te disa matematicient si babai shpirtëror i shkencës së aritmetikës.

Ai shtoi: "Nuk diskutohet në asnjë temë shkencore rreth rëndësisë së internetit pa u argumentuar me havarizmite – algoritme, të cilat i zbuloi astronomi dhe matematikani i madh musliman, i cili vjen nga një vend i quajtur Havarizëm, që tash gjendet në mes të Uzbekistanit dhe Turkmenistanit".

Gazetari gjerman Lerch, njohës i historisë dhe civilizimit islam, përmendi gjithashtu që Havarizmi numërohet si njëri nga shkencëtarët më të njohur në botën arabe dhe islame, në lëmin e matematikës, astronomisë dhe aritmetikës. I njëjtë ishte edhe Ebu Rejhan El-Bejruni, i cili vendosi themelet e para në shkencat e gjeografisë, të hartave si dhe në shkenca të tjera.

Gazetari gjerman paralajmëroi që përkthimet e veprave të El-Havarizmit në mesjetë në gjuhën latine i ndihmuan Evropës që të arrijë deri tek ato që i përdor sot si teori të reja në shkencat e matematikës dhe aritmetikës, duke aluduar për autorin e librit "Algjebra dhe intervista", i cili është themeluesi i bazave të shkencave të algjebrës, i llogaritjes së logaritmit, i pari që e futi në funksion zeron në llogaritje, si dhe zbulues i shenjës së barazimit, shumëzimit, të mbledhjes dhe zbritjes.

Gjithashtu, ai vuri në dukje që El-Havarizmi u mbështet në ekuacionet e tij matematikore në numra dhe shenja matematikore, kurse grekët mbështeteshin në shkronja dhe vizatime.

Shtëpia e Urtësisë

El – Havarizmi pjesën e dytë të jetës së tij e kaloi në Bagdad, kryeqytetin e artë të Hilafetit islam të abasidëve, që në kohën e tij shtrihej nga Afrika Veriore e deri tek Azia qendrore.

Ai, gjithashtu, vuri në dukej rolin e halifëve abasitë në mbështetjen e diturisë dhe inkurajimin e muslimanëve që të hapen ndaj kulturave dhe civilizimeve të ndryshme. Halifi Memun e kishte caktuar El – Havarizmin në krye të "Shtëpisë së Urtësisë" në të cilën shkriheshin idetë dhe përvojat e dalluara të të gjithë dijetarëve, si të atyre muslimanë, po ashtu edhe të tjerëve.

Në fund, kryeredaktori i gazetës Frankfurter Algemajne Cajtung shtoi se: "viti i lindjes së El-Havarizmit mbeti i panjohur, por ndikimi i këtij dijetari të shquar do të mbetet i madh dhe tregues për të gjitha kohërat dhe vendet". ■

Përktheu dhe përshtati nga gjuha arabe prej burimit www.aljazeera.net Sami T. FETAHI


Havarizmij

Rikthimi në monarki

Pasi Muavia iku, banorët e Medinës mbetën të shtangur. Për ta ishte e pabesueshme që krerët e tyre, ose këta katër personalitete, kishin pranuar një gjë të tillë, mirëpo, populli nuk kishte pse të kundërshtonte përderisa këta nuk kishin nxjerrë zë. Kur e pyetën Hyseinin se si e pranove një gjë të tillë, ai ju tha se kishte frikë se do të shkaktohej rrëmujë e madhe dhe do të pësonin shumë viktima të pafajshme

Muhamed J. KAJOLLI

Islami nuk ishte sikur fetë e mëhershme. Ai për dallim nga fetë pararendëse ishte shpallur si fe universale për mbarë njerëzimin dhe në brendinë e tij kishte edhe mënyrën e zhvillimit të sistemit jetësor. Ai i mësoi besimtarët si të veprojnë karshi Krijuesit të tyre, karshi qenies së llojit të vet dhe karshi gjallesave të tjera në univers. Kur ai u shpall, popujt e tjerë jetonin në skllavopronari ose feudalizëm. Si rezultat i sistemit të ri e shumë të sofistikuar karshi shteteve të tjera, muslimanët do të korrnin suksese shumë të mëdha dhe shumë të shpejta, duke filluar që nga fillimi i shekullit të VII-të, në të gjitha nivelet e jetës. Mirëpo, sa ishin në gjendje ta vinin në praktikë atë, ishte çështje tjetër. Sidoqoftë, suksesi i shpejtë dhe shtrirja gjeografike e gjerë, bëri që disa prej elitës politike muslimane të ndikohet nga pushteti dhe pasuria e kësaj bote.

Që këtu filloi edhe ndryshimi midis besimtarëve muslimanë. Të edukuar hollësisht mbi jetën e përkohshme dhe jetën e përjetshme, kalifëve të parë nuk u bëri përshtypje ky pushtet dhe kjo pasuri. Atyre as që iu shkonte ndërmend të emëronin ndonjërin nga bijtë e tyre për trashëgimtar. Me këtë eveniment më së shumti u sprovua kalifi i dytë, Omeri r.a., të cilit i thanë që djali i tij do të duhej të ishte njëri prej gjashtë kandidatëve për kalif. Ai do ta pranonte këtë propozim, por i kushtëzoi ata që ai në asnjë mënyrë të mos zgjidhej për kalif.

Kështu veproi edhe kalifi i tretë dhe ai i katërt. Edhe këta gjithashtu nuk emëruan ndonjë person të familjes së tyre për trashëgimtar, edhe pse pas kalifit të katërt në postin e të parit të muslimanëve erdhi djali i tij Hasani. Kur ky u zgjodh nga besimtarët për kalif, pothuajse në të njëjtën kohë, në anën tjetër, Muavia e shpalli veten për kalif. Tani shteti islam po sprovohej me dy kalifë, mirëpo për ta evituar katastrofën e radhës midis muslimanëve, Hasani, biri i Aliut, i edukuar saktë nga shkolla e Muhamedit s.a.v.s. hoqi dorë dhe kështu populli shpëtoi nga kasaphana e radhës.

Sprova e Muaviut

Muavia përfundimisht mbeti njeriu i parë, i cili do të vendoste për fatin e muslimanëve. Sukseset e tij në zgjerimin e territorit të shtetit islam tani më na janë të njohura edhe për shqipfolësit. Mirëpo në mendjen e tij kishte mbetur një zbrazëtirë, të cilën do të duhej ta plotësonte. Ai kishte derdhur shumë gjak muslimanësh për t'u bërë i pari i këtij shteti të stërmadh dhe, për këtë arsye, ai nuk dëshironte që kjo të përsëritej në një të ardhme nga të tjerët. Si duket në mendjen e tij po qarkullonte ideja që për trashëgimtar të tij ta emëronte djalin e tij, Jezidin,[1] por si do ta shpallte një gjë të tillë kur e dinte fare mirë se një gjë e tillë do të refuzohej nga elita e besimtarëve. Prandaj, për ta realizuar këtë që kishte në mendje, ai do t'i fillonte përpjekjet që në vitet e para të sundimit të tij.

Historianët na sjellin tregime të shumta rreth orvatjeve të tij për realizimin e kësaj ëndrre të tij, të cilat mund të cilësohen si tregime të besueshme. Kemi hasur nganjëherë në disa tregime që nuk kanë pasur përputhshmëri me vitin e ngjarjes, mirëpo, falë literaturës së grumbulluar, mendojmë se kemi mjaft argumente në radhitjen e kësaj kronologjie të prezantuar.

Mugire ibn Shoubete, që nga koha e Omerit r.a., kishte qëndruar në postin e prefektit të Kufes. Kur Muavia u bë kalif, menjëherë do të merrte masa për zëvendësimin e tij dhe do ta zëvendësonte atë me djalin e Amër ibën As-it, Abdullahun. Për ta rikthyer në postin në të cilin ishte "Mugire do të shkonte te Muavia në Damask, për t'i treguar se i qëndronte besnik edhe atij sikurse të tjerëve dhe, ndërkohë, e këshilloi atë se me vendosjen e Abdullahut në Irak ai po rrezikonte shumë, sepse e kishte vënë veten midis kthetrave të luanit. Në Egjipt për prefekt ishte kushëriri i tij Amr ibn As, ndërsa në Irak djali i Amrit, Abdullahu. Muavia vërtet e kuptoi se një ditë kjo do t'i kushtonte shumë, prandaj pa u hamendur shumë ai do ta rivendoste Mugiren në Kuffe.[2] (*Taberi: 5/ f.119 dhe Ethir:4/ f.451*)

Sipas të gjitha gjasave kjo ngjarje ka ndodhur brenda viti 42 h., e jo sikur është theksuar se këshilla e parë nga Mugire kishte qenë një vit ose disa muaj pas vdekjes (i helmuar) së Hasan ibn Aliut, më vitin 49h ose 50h.[3]

Këtë na e vërteton tregimi tjetër i Mugires, i cili është transmetuar nga shumë historianë. Siç duket Mugire nuk kishte më nevojë t'i shprehte lojalitet Muavisë, sepse këtë e kishte bërë në vitin 42 h. dhe Muavia e njihte fare mirë atë. Prandaj ai në vitin 50 h. ishte pak më i moshuar dhe ambiciet e tij për të vazhduar në postin e prefektit kanë qenë më të vogla, sepse vendi në të cilën ai ishte prefekt ishte përfshirë nga epidemia prej së cilës vdiq edhe vetë. "... ajo që e shtyri Mugiren të shkonte në Sham ishte se ai kishte dëgjuar se Muavia do ta zëvendësonte atë dhe në vend të tij do të vinte Seid ibn As-in. Mugire e shfrytëzoi këtë vizitë dhe i propozoi djalit të Muavisë, Jezidit, për trashëgimtar të fronit dhe ai ia përcolli babait të tij. Ndërsa "Muavia këtë propozim ia përcolli gruas së tij, e cila ishte bijë e familjes së Abdu Shemsit, mirëpo bëhej fjalë për Jezidin[4] i cili ishte me një grua tjetër. Ajo iu përgjigj: "Mendoj se Mugire të ka propozuar shkatërrimin tënd të përditshëm. Mirëpo Muavia u zemërua prej saj dhe vazhdoi ta përcillte propozimin e Mugires tek elita politike dhe te mbarë shokët e tij"[5] (*Dinuri:165, Ibn Kethir:6/125, Taberij: 5/203,Ibn el Ethir:4/ 508*)

Nëse ka mundur të ndodhë që Mugire të shkonte dy herë për t'i kërkuar kthimin e tij në postin e prefektit, atëherë mund të themi se këshilla ka mundur të jetë në vitin 50-të, pak ditë para se të vdiste, sipas shumicës së historianëve, mirëpo Dinuri na tregon se debate të shumta janë bërë rreth trashëgimtarit të ri derisa Hasani ka qenë gjallë.[6]

Një ngjarje tjetër e përshkruar nga Ibn Halduni thotë: "Muavia kishte kërkuar nga Amri (prefekti i Egjiptit) që ta vizitonte dhe njëkohësisht të këshillohej me të, që edhe ai t'ia njihte birin e



tij për trashëgimtar. Si duket Amri nuk i ishte përgjigjur pozitivisht ambicies së tij. Më pas, Muavia e dërgoi Jezidin tek Amri pasi mësoi se ai ishte shtrirë në shtratin e vdekjes dhe e këshilloi birin e tij duke i thënë: "Kur të shtrihet në shtratin e vdekjes merre atë dhe hyni brenda në varr[7], nëse ai hyn me ty, aty kërkoja besën. Nëse ndodh që ta pranojë ofertën tënde atëherë bëhet mirë, e nëse e refuzon, varrose aty. Jezidi bëri ashtu siç i tha babai. Amri u detyrua t'ia japë besën dhe i tha se, ky veprim nuk është prej tij, por prej atij që të ka përkundur. Pas vdekjes së Amrit në vitin 43h., Muavia e emëroi djalin e Amrit, Abdullahun për prefekt të Egjiptit." (Haldun:3/ f.8) Ngjashëm thotë edhe Jakubi: 2/ 222.

Gjithashtu, sipas Ethirit 4/ f. 510, kemi edhe tregimin me prefektin e Medinës, Mervan ibn Hakemin, i cili ia ktheu përgjigjen atij me anë të një letre në të cilën e informoi se populli i Medinës nuk është dakord me përzgjedhjen e trashëgimtarit të ri,[8] mirëpo Muavia nuhati prej letrës së tij se edhe vetë Mervani nuk qenka i pajtimit, ndaj e shkarkoi nga detyra dhe në vend të tij e emëroi Seid ibn As-in.[9]

I bazuar në këto tregime, si dhe në disa të tjera të cilat nuk i kemi paraqitur këtu, themi se shumica dërmuese e historianëve thonë se Mugire ibn Shoubete ishte personi i parë që e kishte këshilluar djalin e Muavisë, Jezidin, që ta zinte vendin e babait të tij, e ky i kishte treguar babait të tij për propozimin e Mugires, gjë që ai e kishte pëlqyer. Nëse do ta pranonim si të mirëqenë propozimin e Mugires, mendojmë se ajo ka mundur të ndodhte në vitin 42h. e jo në vitin 50h. Në të kundërtën ky mendim ka mundur të burojë nga vetë Muavia, i cili ka dashur t'i ikte gjakderdhjeve. Pastaj edhe shtetet përreth e kishin këtë traditë dhe, si të tillë, mentaliteti i asaj kohe do ta pranonte pa ndonjë hamendësim të madh këtë ndryshim, me përjashtim të muslimanëve të devotshëm, të cilët ishin kundër rikthimit të monarkisë.

Përpjekja e dytë e Muavisë

Muavia e pa se emërimi për trashëgimtarin e tij ishte shumë i hershëm. Kështu këtë ide ai do ta spostonte për një kohë tjetër. Ai do të presë rastin më të volitshëm për ta riaktivizuar këtë ide dhe në vitin 49h. kemi ndodhinë e helmimit të Hasanit[10]. Pas këtij rasti, Muavia do ta kishte më të lehtë që ta caktonte zëvendësin e tij. Mirëpo edhe kësaj radhe atij do t'i dalin pengesa të paparashikuara.

Muavia kishte kërkuar nga Mugireja që ta përgatiste terrenin në prefekturën e tij për trashëgimtarin e fronit, ndërsa ai e kishte siguruar atë që të mos merrej me krahinën e tij, sepse çdo gjë ishte sipas planprogramit. Mirëpo për fatin e Muavisë, Mugire vdes në vitin 49 ose 50-të të hixhretit. Disa thonë se ai kishte vdekur menjëherë pasi ishte përhapur epidemia vdekjeprurëse.[11] Në vend të tij do të emërohet Zijad ibn Sumeje.[12]

Sipas kësaj ndodhie, ne tani duhet të jemi në fund të viteve 50-të ose 51 ose 52 h., sepse Zijadi ka vdekur në vitin 53 h. pasi që epidemia e njëjtë ishte rikthyer në këtë vend.[13] Muavia do të kërkonte edhe nga Zijadi që ta njihte birin e tij për trashëgimtar. Mirëpo kjo sikur nuk i pëlqeu atij, sepse propozimi i vëllait të tij ishte jashtë çdo tradite islame. Ai, gjithashtu, e dinte se me të nuk duhej të shfaqte edhe dyshimin më të vogël dhe kështu thirri këshilltarin e vet, Ubejd ibn Keab el- Munejrin, për t'u këshilluar.

Ibn Keabi i thotë: "Mos u prish në asnjë mënyrë me Muavinë, e as mos shfaq urrejtje ndaj Jezidit. Unë do ta takoj Jezidin pa e ditur Muavija dhe do ta informoj për barrën që ke. Do t'i tregoj se ty të ka dërguar kalifi letër në të cilën është duke u këshilluar me ty rreth emërimit tënd për trashëgimtar të fronit. Do t'i tregoj për frikën që ke rreth përçarjes së njerëzve dhe mundësinë e urrejtjes rreth teje. Ndërsa ai do ta kuptojë se atë e urrejnë, kështu kalifi do të gjykojë dhe do të jetë argument për njerëzit. Kështu do ta kesh më të lehtë, sepse në njërën anë e ke këshilluar Jezidin dhe, njëkohësisht e ke kënaqur kalifin. Kështu t'i shfaq frikën tënde ndaj umetit." (*Taberi: 5/ 204 dhe Ethir, 4/509*)

Pasi dëgjoi, Muavia e pyeti Ahnafin: "Çfarë thua, o babai i detit? Të themi të vërtetën të frikohemi, gjithashtu edhe Allahut i frikësohemi. Ju e dini më së mirë djalin tuaj o emiri ynë, me të je ditë e natë, ia di sekretet dhe jetën e tij të përditshme private. Nëse e ke mësuar për Allahun, për umetin dhe ata janë të kënaqur, mos pyet askënd. Nëse di diçka tjetër jashtë këtyre mos e ngarko botën, kur ti do të përgjigjesh në ahiret. E jona është të themi atë që dëgjuam dhe e respektojmë. U ngrit një njeri nga banorët e Shamit dhe i tha: "Ne nuk po kuptojmë se ç'po thua o irakian, tek ne nuk ka tjetër përveç fjalëve dëgjuam, iu nënshtruam dhe goditje." (*Ethir, 4/511 dhe Muruxh el Dheheb, 3/ 34, Ibn Kethir, 6/126*)

Në këtë periudhë kohore, Muavia i dërgoi letër edhe Seid ibn As-it, prefektit të Medinës për t'iu treguar sahabëve më të njohur të Pejgamberit s.a.v.s. se Muavia ka ndërmend ta emërojë birin e tij, Jezidin, për trashëgimtar të tij. Ndërsa Seidi ia ktheu përgjigjen: "...ju informoj se populli i këtushëm e mori lajmin me hidhërim. Në veçanti më të zëshëm ishin ata të Ehul el Bejtit[14] ndërsa më armiqësori ishte Abdullah ibn Zubejri. Unë nuk jam më i fuqishëm se ata, me përjashtim me kuaj dhe ushtarë, ndërsa unë jam në pritjen e përgjigjes suaj. Selam." (*Dinuri: 177*)



Pasi u informua me qëndrimin e sahabëve rreth trashëgimtarit të tij, Muavia do t'iu dërgonte letra secilit veç e veç dhe Seidin e urdhëroi që atyre, të cilëve iu ka shkruar letër, me forcë ose pa të, ta njohin djalin e tij për trashëgimtar. Letrat e personave janë si më poshtë vijon: Abdullah ibn Abasit,[15] Abdullah ibn Xhaferit,[16] Husejn ibn Ali-ut,[17] Abdullah ibn Zubejrit.[18] Të gjithë ia kthyen përgjigjen negative dhe e informuan se ata nuk e njohin djalin e tij për trashëgimtar të fronit.

Pas gjithë kësaj ngjarje, Seid ibn As-i, i cili ishte ithtar i denjë i Muavisë, ia kthen përgjigjen: "Për fat të keq, asnjëri prej tyre dhe tërë qyteti nuk e përkrahin djalin tënd për trashëgimtar". Për këtë arsye Muavia do të duhej të merret vetë me këtë punë të ndërlikuar me banorët e Medinës, të cilët konsideroheshin si pjesa më kryesore e emërimit të kalifit në shtetin islam të asaj kohe.

Muavia në Medinë

Pas përpjekjeve të tij të gjata, si duket elita e Shamit, Egjiptit dhe e Irakut në përgjithësi ishin pajtuar që Jezidi të bëhej trashëgimtari i tij. Tani ai do të duhej vetë të merrej me popullin e Hixhazit (Gadishullin arabik). Mu për këtë arsye, Muavia do të merrte rrugëtimin e tij për në Umre, në vitin 56-të të hixhretit, në të cilën do të ndalonte fillimisht në qytetin e Medinës.

Me të arritur në Medinë, ai e pa Hyseinin (nipin e Pejgamberit s.a.v.s.), më pas e pa edhe Abdullah ibn Zybejrin, Ibni Omerin, Abdurrahman Ebi Bekrin,[19] të cilëve nuk ju uroi shëndet e as nuk i përshëndeti përzemërsisht. Para se të shkonte në rezidencën e vet, shkoi në shtëpinë e Aishes r.a. dhe i tha asaj: ... "E pashë Hysejnin dhe shokët e tij. Do t'i vras nëse nuk do t'ia japin besën djalit tim dhe filloi t'i ankohej asaj. Aisheja i tha: "Nga sa po shoh, po vazhdon me kërcënime dhe vrasje". Ai i tha: "Oj nëna e besimtarëve, ata janë më



të shtrenjtë tek unë se të gjithë të tjerët, mirëpo të gjithë e kanë pranuar Jezidin për trashëgimtarin tim. A po më thua se duhet ta ndërpres këtu, kur të gjithë ia dhanë besën?" Ajo i tha: "Shoqërohu me ata, se ata do të shpien aty ku ti po dëshiron inshaAllah". Ai i tha: "Do ta bëj". Ajo pastaj i tha: "Ç'të bëri të besosh të uleshe këtu, a nuk të shkoi ndërmend se dikush mund të vinte për të të vrarë? Ti e di se ç'bëre me vëllain tim." Ai i tha: "Jo, oj nëna e besimtarëve, unë jam në shtëpi të sigurt." Ajo i tha: "Po, ashtu është". (*Dinuri:183*)

Muavia i ftoi personat të cilët duhej ta pranonin djalin e tij për trashëgimtar. Të parin e ftoi Huseinin: "Mirëserdhe, o biri i Pejgamberit dhe zotëria i rinisë muslimane... dhe me të qëndroi pak dhe pastaj i lejoi të tjerët të hyjnë tek ai dhe ua tregoi arsyet pse djali i tij duhej të emërohej si trashëgimtari i tij. Abdullah ibn Zubejri i tha: "Le të bëhet Pejgamberi s.a.v.s. shembull yt". Muavia ia ktheu: "Nuk është askush nga ju sikur Ebu Bekri që ta bëj një gjë të tillë". Atëherë bëje siç bëri Ebu Bekri që zgjodhi njeriun më të përshtatshëm dhe jo nga familja e tij, nëse këtë nuk mundesh, atëherë bëje sikur bëri Omeri: zgjidh gjashtë kandidatë, me kusht që djali i tij të mos zgjidhet". Muavia i tha: "Keni ndonjë propozim tjetër?" Ata i thanë jo.

Muavia iu tha se kjo gjë ka marrë



fund, nëse dikush prej jush do të më kundërshtojë gjatë fjalimit tim, do t'ia heq kokën. Aty për aty, caktoi nga dy persona të armatosur t'iu qëndrojnë mbi koka nëse ndokush prej tyre do ta kundërshtonte fjalimin e tij. Kur erdhi koha, ai u ngrit në mimberin e xhamisë dhe e informoi popullin se djali i tij do të jetë trashëgimtar i fronit pas vdekjes të tij dhe këtu keni pëlqimin e katër personaliteteve më të njohur ndër ju. Populli ia dha besën pasi nuk kundërshtuan ata katër personat. (*Ethir: 4/ 512-513, Tabri 5/ 203*)

Pasi Muavia iku, banorët e Medinës mbetën të shtangur. Për ta ishte e pabesueshme që krerët e tyre ose këta katër personalitete e kishin pranuar një gjë të tillë, mirëpo populli nuk kishte pse të kundërshtonte nëse këta nuk nxorën zë. Kur e pyetën Hyseinin se si e pranove një gjë të tillë, ai ju tha se kishin frikë se do të shkaktohej rrëmujë e madhe dhe se do të pësonin shumë viktima të pafajshme.

Pasi u sigurua se banorët e Medinës e kuptuan mesazhin, ai mori rrugën për në Mekë për të bërë umren. Me vete i mori edhe këta katër personalitetet më të njohura të Medinës, të cilët njëkohësisht ishin edhe personalitetet e mbarë umetit të muslimanëve. ■

---

1 Për ta trashëguar djali i tij, Muavia e mori këshillën nga Mugire ibn Shoubete. Thuajse të gjithë historianët, të cilët janë marrë me këtë periudhë të historisë, e vërtetojnë këtë, me përjashtim të disa pak prej tyre. "...i propozoi kalifit që për trashëgimtar të fronit të tij ta emërojë djalin e vet, Jezidin, me arsyetim se mjaft kishte vuajtur ky umet në përzgjedhjen e kalifit..." (Dinuri:165, Ibn Kethir:6/125, Taberij: 5/203,Ibn el Ethir:4/ 508)

2 I bazuar në tregime të tjera të radhës, unë mendoj se në këtë takim Mugire i ka propozuar Muavisë që trashëgimtar i fronit të bëhej djali i tij, edhe pse nuk është thënë nga historianët e hershëm.

3 Siç kemi theksuar, Hasan Ibn Aliu kishte dhënë dorëheqje nga posti i kalifit, për ta marrë atë sërish pas vdekjes së Muavisë. Mirëpo ai vdiq para Muavisë.

4 Nëna e të cilit ishte prej fisit Kelbe. Një grua tipike beduine, e cila e kishte edukuar djalin e saj sipas traditave beduine arabe. Mirëpo historianët tregojnë se Muavia e kishte për zemër shumë këtë grua.

5 Duket që kjo ngjarje të mos ketë ndodhur në vitin 50 h. Këtu kemi të bëjmë me ngjarje të ngjashme të vitit 42 h. dallimi i së cilës është vetëm emri i personit që do ta zëvendësonte. Allahu e di më së miri.

6 Historianët e hershëm, si Dinuri e Taberi, kur i kanë përshkruar ngjarjet nuk kanë treguar datën ose vitin e ndodhjes. Ata janë përqendruar vetëm në ngjarjen. Në këtë rast Dinuri e përshkruan fjalimin e Ahnaf ibn Kajsit, ndërsa ai i thotë Muavisë se populli i Hixhazit dhe i Irakut nuk do të pajtohen me këtë propozim derisa Hasani është gjallë...

7 Muslimanët e pasur të Egjiptit nuk i kanë ndryshuar traditat egjiptiane të varrezave familjare, që nga koha e faraonëve. Një i huaj nuk mund t'i dallojë varrezat egjiptiane nga lagjet e një qyteti. Varri i ngjason një shtëpie të vogël njëkatëshe me dy ose tri dhoma. Në bodrumet e tyre vendosen xhenazet (kufomat) e familjes. Dhomat sipër bodrumeve iu shërbejnë për hije gjatë vizitave që ua bëjnë për lutje.

8 Ethiri ka veçuar debatin midis Mervanit dhe elitës politike e shkencore të Medinës. Pasi i informoi ata për trashëgimtarin e fronit, të gjithë ata e kanë përgënjeshtruar atë, ndërsa në këtë rast më i zëshëm paska qenë Abdurrahman ibn Ebi Bekri. Për t'ia mbyllur gojën, Mervani i thotë atij: Ti hesht, se je shkaku i zbritjes së një ajeti. "Dhe ai i cili i thotë prindërve të tij Uf!" (Ahkaf: 17) E solla këtë argument këtu të them se Aishja, Hasani dhe Kitade e kundërshtojnë njëherësh Mervanin dhe i tregojnë atij se Abdurrahmani nuk ka qenë shkaktar i zbritjes së këtij ajeti, por ishte një njeri tjetër. Ky është edhe një argument se kur paska dhënë informacionin Mervani për trashëgimtarin e Muavisë, Hasani paska qenë gjallë. Kjo tregon se loja Muavi-Mugire paska filluar që herët.

9 Muavia ka qenë i njohur në ndërrimin e posteve të prefektëve.

10 Shumica e historisë islame, deri në shekullin e III-të h., është shkruar në kohën e dinastisë abasite, ndërsa në kohën e dinastisë emevite të dhënat rreth Muavisë, Alisë r.a. dhe djemve të tij kanë qenë të censuruara. Se cila është e vërteta e vdekjes së tij ne nuk mund të themi asgjë, me përjashtim të asaj që thotë shumica dërmuese e historianëve. Ai ishte mbytur nga një urdhër që kishte dalë nga oborri i rezidencës së Muavisë. Disa thonë se ideatori i vrasjes së Hasanit kishte qenë vetë Muavia, e disa të tjerë thonë se ishte Jezidi. Thuhet se, si Muavia ashtu edhe Jezidi i kishin premtuar gruas së Hasanit martesën me Jezidin, mirëpo ajo u tradhtua pasi e kreu vrasjen.

11 Shumica e historianëve thonë se epidemia ishte paraqitur në vitin 49-të h., ndërsa Mugire paska ikur nga vendi i tij që në fillim të përhapjes së epidemisë. Mirëpo, thuajse një vit më vonë, atij i kishin arritur lajme se epidemia ishte larguar dhe ai ishte kthyer në vend. Lajmi kishte qenë jo i vërtetë dhe ai kësaj radhe nuk arriti t'i ikte sëmundjes, prej të cilës vdiq pak ditë më vonë. Pra, në vitin 50-të h.

12 Zijadi, i vëllai i Ebu Bekrete. Është quajtur i biri i Sumejes sipas nënës së tij, sepse babai i tij ishte i dyshimtë. Këtë dilemë e largoi Ebu Sufjani, babai i Jezidit, i cili në një rast tregoi mënyrën e ngjizjen e tij në prani të Aliut r.a. Me të ardhur në post, Muavija do ta njihte për vëlla dhe kërkoi prej tij që t'i linte anash hasmëritë me të. Derisa Muavia po luftonte me Alinë, Zijadi mbante qëndrim armiqësor ndaj Muavisë, mirëpo pas pajtimit me Muavinë ai do të njihet deri në vdekje me emrin Zijad ebu Sufjan.

13 Disa historianë thonë se kjo ngjarje ka ndodhur në viti 56 h. Mirëpo shumica dërmuese e historianëve dhe bibliografëve na argumentojnë se Zijadi ka vdekur në vitin 53 h.

14 Trashëgimtarët e familjes së Muhamedit s.a.v.s.

15 Përmbajtja e letrës…Sa për sigurinë tënde mos u brengos, kur të vijë letra ime dil te Qabeja dhe mallkoi vrasësit e Osmanit r.a. dhe jepja besën prefektit. U fal kush u fal, ndërsa ti e di më së miri për veten tënde. We Selam.

16 Letra: U informova për ju, respekti im ndaj teje dhe përfaqësuesve të tu është i lartë. Një fjalë e mirë e jotja ndikon tek Ehlul Bejti. Mora vesh për atë që të shqetëson, nëse e jep besën do jesh i falënderuar, por, nëse e kundërshton atë do të rikthehet përsëri thyerja. We selam.

17 Letra: Unë me ty sikur kisha mbaruar punë. Nuk të kisha paramenduar prej mesit të tyre. Ai i cili ma do vdekjen më së shumti janë ata sikurse shembulli yt. Për shkak të pozitës që gëzon në shoqëri, për ata që përfaqëson dhe për atë që ta ka dhënë Allahu, mos më kundërshto në këtë pjesë dhe kije frikë Allahun. Mos e dërgo këtë umet në degjenerim, shikoje veten, fenë tënde, umetin e Muhamedit dhe mos të të frikësojnë ata të cilët nuk dinë.

18 Ndërsa letra e Abdullah ibn Zubejrit është e shkruar në formë poezie…përmbajta e ngjashme me të tjerat dhe kërcënuese.

19 Disa historianë thonë se Abdurrahmani kishte vdekur më 53h, por ky takim tregon se ai ka vdekur më vonë.

Ta marrim vesh mirë: p arabe kërkon një tregi

John L. ESPOSITO &
Dalia MOGAHED

Zakonet e vjetra vështirë vdesin. Kur vlerësojmë sfidat politike të dala prej qeverive të reja në Egjipt, Tunizi dhe gjetiu në territorin e Lindjes së Mesme, ne vazhdojmë të kapemi pas një tregimi të dështuar.

Duke zbritur nga aeroplani dhe duke ecur nëpër aeroport në rrugën time për në konferencën "SHBA-ja në një Lindje të Mesme që po ndryshon", më zuri syri ballinën e revistës The Atlantic. Ajo që më tërhoqi vëmendjen nuk ishte titulli i kryeartikullit "Rrezik: tiranë që po bien" por fotografia e një gruaje të mbuluar ku i shiheshin vetëm sytë dhe titullin "A është kjo fytyra e demokracisë arabe?"

Sunduesit autoritarë në botën arabe dhe qeveritë perëndimore dhe komentuesit politikë me dekada kanë justifikuar mbështetjen për regjimet autoritare represive, duke pohuar se "kaosi" është alternativa dhe se ardhja në pushtet e muslimanëve dhe kultura arabe dhe Islami janë jokompatibile me demokracinë. Kryengritjet arabe kanë diskredituar mençurinë tradicionale dhe kanë sfiduar politikbërësit të kërkojnë një tregim të ri. Në vend të kësaj, këto kryengritje konfirmojnë atë çfarë sondazhet e mëhershme raportonin: përderisa feja mbetet e rëndësishme, shumica e botës islame preferon demokracinë ndaj teokracisë.



Sondazhi i fundit i Gallup 'Egjipti prej Tahririt në tranzicion' ofron perceptime të rëndësishme në qëndrimet egjiptiane, një numër i të cilëve kanë një qëndrim të drejtpërdrejtë për mençurinë tradicionale dhe frikën: regjimet autoritare në Egjipt, Tunizi dhe gjetiu janë mburojë e triumfit të muslimanëve (islamistëve), "Iranëve të tjerë" dhe imponimit të shteteve islame. Egjiptianët virtualisht nuk kanë interes (1%) në modelimin e sistemit politik sikurse e kanë ata të Republikës Islamike të Iranit. Shumica e egjiptianëve (69%) mendojnë që udhëheqësit fetarë duhet të jenë të kufizuar në rolin e këshilltarëve për autoritetet qeveritare. Veç kësaj, përkundër një imazhi të mirë në shumicën e egjiptianëve, legjendarja Vëllazëria Muslimane nuk ka më tepër se 15% të "mbështetjes" publike. Shumica jo vetëm që nuk e mbivlerëson mbështetjen për islamistët, por shumica pretendojnë se kjo preferencë është sinonime me antiamerikanizmin për dhjetëra vite. Faktet flasin ndryshe. Në bazë të sondazhit të Gallup, mbështetësit përbrenda Vëllazërisë Muslimane, që janë pak më shumë (25%) se sa publiku i përgjithshëm (18%), e miratojnë udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara.

Të dhënat e Gallup-it nxjerrin në pah një tjetër keqkuptim të krijuar: predispozitat e muslimanëve për dhunën. Përkundrazi: egjiptianët më së shumti në botë thonë se shënjestrimi dhe vrasja e civilëve nuk arsyetohet asnjëherë (97%). Terrorizmin si taktikë në baza morale nuk e kundërshtojnë vetëm egjiptianët, por shumica në Lindjen e Mesme (79%) gjithashtu besojnë se 'mjetet dhe mënyrat paqësore janë të efektshme për të korrigjuar padrejtësinë'.

Kapja pas një tregimi të dështuar dhe kërcënimit të një pushtimi armiqësor të Islamit, rrezikon në dorëzimin e përpjekjeve për të 'inkurajuar' ose influencuar një rezultat specifik në zgjedhjet arabe, të cilat do të vërtetojnë brengat e egjiptianëve dhe botës arabe. Shumë egjiptianë mbesin të shqetësuar për ndërhyrjen e mundshme të SHBA-së në punët e tyre politike. Në bazë të Gallup-it, dy të tretat e egjiptianëve mendojnë se SHBA-ja do të mundohet të ndërhyjë në të ardhmen politike të Egjiptit, në vend se të lihet që populli që të vendosë vetë për

ranvera
im të ri

vendin e tyre. Veç kësaj, një numër i njëjtë nuk pajtohet që SHBA-ja është serioze për inkurajimin e sistemit demokratik të qeverisë në regjionin e tyre. Për të ndërtuar besimin dhe për të fuqizuar marrëdhëniet tona me shoqëritë e autorizuara të reja arabe duhet që të qëndrojmë në parimet demokratike, jo të mbështetemi në partitë politike ose individët.

Sikurse të gjithë njerëzit, populli i Egjiptit do që të krijojë një të ardhme politike të pavarur -- veçanërisht ata që admirojnë parimet demokratike amerikane. Pothuajse 90% e egjiptianëve, që e shohin SHBA-në si modelin e duhur politik për vendin e tyre, e kundërshtojnë ndihmën e SHBA-së për grupet politike në Egjipt, që përbën shumicën që kanë këtë pikëpamje në mesin e publikut të përgjithshëm (75%). 52% e egjiptianëve e kundërshtojnë ndihmën e pranuar ekonomike si të një tërësie -- 43% prej të cilëve besojnë se Egjipti duhet të shikojë modelin e demokracisë së SHBA-së.

Kur shikojmë emergjencën e qeverive të reja dhe përpjekjet e vazhduara për ndryshim të regjimeve ose reformave demokratike, duhet që të lëvizim përtej tregimit të tashëm diskret dhe të mbështetjes së arabëve, por të ndalemi, e të shohim ushtrimin e lirive të shumta, të cilat vetë ata do t'i manifestojnë, liri këto në të cilat Amerika ishte themeluar dhe të cilat i ushqejmë dhe promovojmë. ■

John L. Esposito është profesor universitar dhe drejtor themelues i Qendrës për Mirëkuptim Islamo-Krishter. Ai është bashkautor i librit "Kush flet për Islamin? Çfarë në të vërtetë mendojnë miliona myslimanë?" dhe autor i librit "E ardhmja e Islamit".

Dalia Mogahed udhëheq Qendrën Abu Dhabi Gallup dhe Qendrën për Studime Islame. Është bashkautore e librit "Kush flet për Islamin? Çfarë në të vërtetë mendojnë miliona myslimanë?"

Revista "Paqja" ka lejen për të botuar këtë shkrim, pasi ka lejen e autorizuar nga profesori Esposito për botimin në gjuhën shqipe.

Përktheu: Osman D. GASHI



NATO E LODHUR ME LIBINË

"The Economist"

Pas tre muajsh lufte në Libi, deklaratave të sigurta të NATO-s për mposhtjen e forcave të Gadafit, tani i është shtuar edhe frika se Aleanca Atlantike po rrezikon të lodhet nga një fushatë ushtarake e zgjatur. Komandanti britanik i Forcave Detare tha se, nëse lufta do të vazhdojë përtej vjeshtës, do të marrim "vendime të vështira" në vendosjen e anijeve. Homologu i tij francez është ankuar se në qoftë aeroplanmbajtësja e tyre do të jetë e vetme, "Sharl De Gol" dhe do të vazhdojnë të patrullojë nëpër brigjet e Libisë për pjesën tjetër të vitit, do të duhet që anija të hiqet nga shërbimi për mirëmbajtje deri në vitin 2012. Norvegjia, një nga aleatët më të gatshëm për intervenim, tani thotë se forca e saj e vogël ajrore nuk mund të përballojë një përkushtim të tillë: duke reduktuar sulmet, nga 1 gushti të pushojë krejt. Në fillim të luftës në Libi, europianët mendonin për një angazhim të Amerikës, por tani që kontrolli i ka kaluar operacioneve të NATO-s, vazhdojnë të varen nga Amerika për identifikimin e objektivave dhe operacioneve ajrore për furnizim me karburant. Ekspertët amerikanë u transferuan me ngut në komandën e NATO-s, në Napoli. "Aleanca më e fuqishme ushtarake në histori – tha ish-sekretari amerikan i mbrojtjes Robert Gejts - filloi që nga njëmbëdhjetë javë, veprimet kundër një regjimi pak të armatosur me një komb shumë pak të populluar, por disa aleatëve janë duke u mbaruar municionet dhe kërkojnë që Shtetet e Bashkuara, edhe një herë tjetër të bëjnë diferencën. Arsyeja që qëndron prapa në këto dështime nuk është një mister. Shumica e shteteve europiane shpenzojnë shumë pak në mbrojtje dhe shpesh shpenzojnë keq. Që europianët e kanë të vështirë, ushtarakisht dhe politikisht, për të mbajtur dhjetëra mijëra ushtarë në Afganistan, është e kuptueshme. Që ata janë duke treguar shenja të lodhjes në një fushatë ajrore në kufijtë e saj (edhe pse më pak intensive se ajo e Kosovës në vitin 1999) sugjeron se, megjithatë, ka diçka tjetër. Libia zbulon një aspekt të turpshëm të NATO-s. Fuqia e saj ushtarake është kryesisht e përcaktuar nga ajo që Amerika është e gatshme për të bërë. Pa Amerikë, forca ushtarake e ndikimit, edhe aleatët më të fuqishëm europianë, si Britania dhe Franca, është e kufizuar. Për më tepër, siç u vu në dukje nga vetë Gejts: Europianët duhet të kuptojnë që angazhimi i Amerikës nuk është i përhershëm. Gejts është një nga skifterët e fundit të "Luftës së Ftohtë", që ka pasur një post qeveritar. Një brez i ri liderësh ndoshta s'mund të ndajnë të njëjtin përkushtim për Aleancën dhe mund ta konsiderojnë atë si një barrë. Vetëm nëse Europa nuk do të



bëjë më shumë, atëherë NATO është e dënuar për një "mungesë ushtarake" dhe një të ardhme "të errët dhe të zymtë". Fjalët e Gejts-it mund të shihet si ankesa të pashmangshme të një politikani në rrugën e daljes në pension. Të gjitha administratat e SHBA-ve i kanë bërë thirrje Europës për të marrë një peshë më të madhe në Aleancë. Ka kaluar një kohë e gjatë që nga misioni për të cilin NATO-s u krijua: për të kundërshtuar Bashkimin Sovjetik. Pastaj gjithmonë ka pasur një pyetje të vazhdueshme në lidhje me qëllimet e reja të Aleancës, por tani ka angazhime më shumë se kurrë. Ndërkohë - siç vuri në dukje Kurt Volker, ish-ambassador amerikan në NATO – është zëvendësuar nga një ndryshim në mentalitet: "Për europianët, NATO është Amerikë. Për Amerikën, NATO do të thotë Europë. Dhe tani Aleanca nuk i përket askujt". Një tjetërsim i tillë mund t'i bëjë gjërat edhe më keq. Me përfundimin e Luftës së Ftohtë, shqetësimet e sigurisë kombëtare të Amerikës u zhvendosën nga Europa në Lindjen e Mesme, Azia Jugore dhe, së fundi, në Kinë. Europa duhet të kujdeset vetë për sigurinë e saj, vlera e saj qëndron në atë që ajo mund të ofrojë. Por kriza e borxhit shkakton shkurtime në buxhetin e mbrojtjes në Europë. Vetëm tre shtete kanë arritur, për momentin, qëllimin e NATO-s, që të kalojnë të paktën 2% të GDP-së në fushën e mbrojtjes: Britania, Franca dhe Greqia. Shumë të tjerë shpenzojnë vetëm 1% ose më pak. Shpenzimet duhet të krahasohen me SHBA-të dhe 5% të PBB-së tyre. Dhe duke pasur parasysh se Amerika është duke u përgatitur për të zvogëluar shpenzimet ushtarake, do të jetë edhe më e vështirë për njerëzit në Europë të bëjnë më shumë. Shumë të holla, rezultate të dobëta. Amerika nuk dëshiron të përfshihet në veprime ushtarake. Edhe qëndrimi i saj në rreshtin e dytë provokon kritika në frontin e brendshëm. Mesdheu Jugor duhet të jetë një fushë me rëndësi jetike për Europën. Nëse nuk mund të veprojnë në këtë teatër, atëherë pse të shpenzojë 275 miliardë dollarë në mbrojtje? Në këto ditë të kursimit, europianët me siguri nuk do të shpenzojnë më shumë. Por shkurtimet në mbrojtje do të shpëtohen së paku pa shpenzuar, dhe mund të koordinohen më mirë, në mënyrë që NATO të mbetet një forcë e balancuar. Tani më shumë se kurrë, europianët kanë nevojë që të marrin më shumë nga paratë e tyre. Ata kanë më shumë ushtarë se amerikanët, por jashtë shtetit mund të dërgojnë më pak. Buxhetet e tyre janë të fragmentuara në mori ushtrie, me Forcat Detare dhe Forcat Ajrore. Europa prodhon njëzet lloje të ndryshme tankesh, gjashtë lloje të ndryshme të nëndetëseve sulmi, tre modele avionësh gjuajtës. Me koston e pajisjeve ushtarake që rritet më shpejt se inflacioni, vendet europiane thjesht, duhet të gjejnë ekonomi të shkallës më të mirë. Kjo nuk do të thotë krijimin e një ushtrie europiane, siç propozojnë disa. Një nismë e tillë është rruga për paralizë: mjafton të mendoni dërgimin e një brigade frankogjermane në Afganistan, për të mos përmendur Libinë. Asnjë nga këto që thamë nuk është e lehtë. Një shtet nuk dëshiron të varet nga një vend tjetër, ose të tërhiqet zvarrë në një luftë tjetër. Disa shtete kanë industri në sektorin e mbrojtjes dhe duhet të mbështeten. Por, Danimarka ka braktisur nëndetëset e saj dhe ka marrë një rol udhëheqës në Afganistan dhe në Libi. Disa vende ndajnë avionë të transportit C-17. Pakti mbrojtjes Franko- britanik i vitit të kaluar tregon rrugën që duhet përshkruar: të dy vendet do të bashkëpunojnë, ndër të tjera, në teste bërthamore, operacione ajrore dhe detare, pak spektakolare por jetësore në operacionet e mbështetjes së civilëve dhe do të formojnë një forcë të ekspeditës së përbashkët. ■

Përktheu: Arsim JONUZI

Gëte si musliman

E gjithë kjo e inspiroi Gëten, që të shkruajë "Divanin Perëndimor-Lindor" ("West-Östlicher Divan") të tij, i cili në anën tjetër përmban shumë poezi të ndikuara në mënyrë shumë të qartë prej Kuranit dhe të cilat lidhen me ajete të ndryshme kuranore

Shejh 'Abdulkadir AL-MURABIT

Gëte dhe Krishterimi

Gëte, nga fundi i jetës së tij, tha: "Ka shumë marrëzira në doktrinat e Kishës." (Eckermann, 11.03.1832)

Në veprën e tij "Divani Perëndimor-Lindor" ("West-Östlicher Divan"), Gëte paraqet vlerën e çmuar të së tashmes kundër pikëpamjes krishtere të pritjes së botës së ardhshme, e cila përçmon në këtë mënyrë të gjithë ato begati e të mira që Zoti i dhuron njeriut në çdo çast të jetës së tij.

Gëte e refuzoi pikëpamjen krishtere për Jesusin (Isën a.s.) dhe dëshmon Njëshmërinë e Allahut në një prej poezive të tij në veprën "Divani Perëndimor-Lindor":

"Jesusi ndihej i pastër dhe mendonte
Një dhe të vetmin Zot në qetësi;
Ai që e bëri atë vetë për zot
Lëndoi vullnetin e shenjtë të tij.
Dhe kështu duhet të ndriçojë e drejta
Atë që edhe Muhamedi e arriti
Vetëm me anë të Njëshmërisë
Ai gjithë botën e nënshtroi (dhe e përndriti)."

(WA I, 6, faqe 288)


Krahas Jesusit (Isës a.s.) dhe Muhamedit a.s. – paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi të, Gëte në vargjet vijuese përmend po ashtu edhe Abrahamin (Ibrahimi a.s.), Moisiun (Musën a.s.) dhe Davidin (Davudin a.s.) si reprezentues të Njëshmërisë së Zotit. Është fakt i njohur që Gëte ndjeu një aversion të madh kundër simbolit të kryqit. Ai shkroi:

"Dhe tash më vjen ti, me një shenjë
Të Varur, që veç tjerash…
Mua s'më pëlqen aspak
Gjithë këtë marrëzi moderne
Do ma sjellësh për në Shiras!
A mos vallë unë u deshka me gjithë ngurtësinë e tij
Për dy copa druri të kryqëzuara që të këndoj?..."

Madje në një artikulim edhe më të fuqishëm:

"Mua donë t'më paraqitesh për zot
Eh, çfarë figure e mjerë mbi dru!"

Po ashtu, edhe në veprën "Wilhelm Meisters Wanderjahre" (libri 2, kapitulli 2) Gëte shkroi në mënyrë shumë direkte, duke thënë se është "arrogancë e paskrupullt ndaj dinjitetit të luash me ato fshehtësi të mëdha, në të cilat fshihet vuajtja e thellë hyjnore". Sipas tij, më mirë do ishte "të vihej një mbulesë sipëri mbi këto vuajte."



Dokument i Gëte-s ku fillon letrën me Bismi lahi rrahmani rrahim Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit

Dhe së fundi, në poezinë e tij "Shtatë të fjeturit" ("Siebenschläfer") të Divanit Perëndimor-Lindor, Gëte e quan dhe e konsideron Jesusin si profet (të dërguar),

"Bëhen vite që tashmë Efesi
Nderon mësimin e profetit
Jesus" (Paqja qoftë me të mirin!)

(WA I, 6, 269)

Asketizmi dhe madhërimi i Zotit

Gëte qe fascinuar nga metafora mistike e Saadiut si "mushkonja e dashuru-


Gëte

ar" që digjet në dritën vdekjeprurëse. Kjo i referohet veçanërisht poezisë së divanit "Malli i zjarrtë" ku flutura fluturon drejt dritës. Titujt e mëhershëm të kësaj poezie quheshin "Vetëflijim" dhe "Përkryerje".

Në kapitullin e Divanit për Rumi-un, Gëte përshkruan kërkimin e Allahut dhe bekimin e tij:

"Edhe me të ashtuquajturën rruzare muhamedane, përmes së cilës emri i Allahut me nëntëdhjetenëntë cilësitë e Tij lartësohet, është një litan lavdërimi dhe adhurimi unikat. Cilësitë pohuese dhe mohuese tregojnë për Qenien e papërfytyrueshme, lutësi mahnitet, nënshtrohet dhe qetësohet në tërësi." (WA I, 7, 59).

Gëte dhe Islami

Qysh në rini, Gëte deshi të studiojë filologji, përkatësisht arabistikë – por i ati i tij dëshironte që ai të merrej me studime juridike; kështu ai gjatë tërë jetës së tij i admiroi udhëtarët e parë të Arabisë (Michaelis, Niebuhr) dhe i mrekulluar lexoi gjithçka që ata publikuan në lidhje me udhëtimet e tyre.

Kur në vitet 1814-1815 Gëte përmblodhi Divan-in e tij, ai me profesorin e orientalistikës Paulus, Lorsbach dhe Kosegarten (Jena) kishte ushtruar leximin dhe shkrimin e arabishtes.

Pasi kishte parë dorëshkrime në arabisht dhe pasi qe njohur me Kuranin, Gëte ndjeu një dëshirë të madhe për të mësuar arabishten. Ai kopjoi me dorën e vet tekste të shkurta të lutjeve dhe shkroi: "Me siguri se në asnjë gjuhë tjetër shpirti, fjala dhe shkrimi nuk kanë qenë kaq mirë të shkrira që prej fillimi në njësh." (Brief an Schlosser-it, 23.1.1815, WA IV, 25, 165)

Në moshën shtatëdhjetëvjeçare, Gëte shkroi (Noten und Abhandlungen të Divanit-Përendimor-Lindor, WA I, 7, 153), atë çfarë synonte:

"Qoftë lavdëruar ajo natë e bekuar,
në të cilin Kurani i Madhëruar
i zbriti Profetit i tëri nga lart".

Ai shkroi gjithashtu: "Askush s'duhet befasuar me ndikimin madhështor të këtij librit (Kuranit). Ky është shkaku përse admiruesit e flaktë e kanë quajtur të pakrijuar dhe të përjetshëm me Zotin." Dhe kishte shtuar: "i tillë do të mbetet ky libër për jetë e mot me ndikimin e tij piedestal". (WA I, 7, 35/36)

Që prej atëherë e deri tani ne i posedojmë dorëshkrimet e tij të para studimore të Kuranit të viteve 1771-1772, si dhe ato të mëvonshme. Gëte u lexonte anëtarëve të familjes së Dukës së Vajmarit dhe mysafirëve të tyre me zë Kuranin e përkthyer gjermanisht nga J. Hamer (me gjasë, po ashtu, edhe përkthimin më prozaik të Kuranit në anglisht nga G. Sale). Schiller dhe bashkëshortja e tij dëshmojnë për këtë lexim.

Gëte gjithmonë i kishte ndier mangësitë e përkthimeve të Kuranit në latinisht, anglisht, në frëngjisht dhe kërkonte vazhdimisht përkthime të botimeve të reja.

Në Divanin e tij ai thotë:

"Se a është Kurani nga Përjetësia?
Për këtë gjë unë nuk pyes!
Që ai është Libri i Librave
Nga detyrë e muslimanit unë besoj"
(WA I, 6, 203)

Ai studioi libra doracakesh në arabisht, libra të gramatikës, të udhëpërshkrimeve, të poezive, të antologjive dhe libra për jetën e të dërguarit Muhamed - paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të; dhe mbante kontakte shumë intensive me orientalistë nga e tërë Gjermania. Gëte e vlerësonte lart përkthimin e Hafis-it në gjuhën gjermane (Maj 1814) dhe studioi përkthimet e ndryshme të Kuranit të kohës së tij. E gjithë kjo e inspiroi Gëten që të shkruajë "Divanin Perëndimor-Lindor" të tij, i cili në anën tjetër përmban shumë poezi të ndikuara në mënyrë shumë të qartë prej Kuranit dhe të cilat lidhen me ajete të ndryshme kuranore.

Gëte bleu të gjitha dorëshkrimet arabe të Rumit, Xhamit, Hafis-it, Attar-it, Tefsirin e Kur'anit, lutje të ndryshme, një fjalor arabisht-turqisht, libra me tematikë të lirimit të skllevërve, libra për shitblerje, për kamatën si dhe dorëshkrime origjinale të Sulltan Selimit.

Gëte nuk e konsideronte si rastësi, por si ngjarje shumë të rëndësishme, domethënë si përcaktim (kadër) dhe shenjë nga Allahu, kur atij në vjeshtë të vitit 1813 prej Spanjës iu soll, nga një ushtar që po kthehej për në shtëpi, një dorëshkrim i vjetër në gjuhën arabe, i cili përmbante suren e fundit të Kuranit "En Nas" (114). Më vonë me ndihmën e profesorëve nga Jena, Gëte bëri përpjekje ta kopjojë me dorën e vet dhe ata e ndihmuan ta zbërthente përmbajtjen e dorëshkrimit.

Në janar të vitit 1814, ai (Gëte) mori pjesë me muslimanët në faljen e xhumasë në gjimnazin e Vajmarit, së bashku me Bashkirët që gjendeshin në ushtrinë ruse të Carit Aleksandër. Në letrën për Trebra-n e datës 5.1.1814 (WA IV, 24, 91), ai shkroi:

"Meqë po flas për profeci, duhet të theksoj që në kohën tonë po ndodhin gjëra, për të cilat nuk do të lejohej të fliste asnjë profet. Kush do të mund ta paramendonte më herët se dikush do të lajmëronte që në sallën e gjimnazit tonë protestant do të mbahej ceremoni muhamedane (*është fjala për faljen e xhumasë, A.Xh) dhe se do të këndoheshin suret e Kuranit gjithandej; por ja që ndodhi, ne morëm pjesë në lutjet e Bashkireve, kemi shikuar hoxhën dhe princërve të tyre u shprehëm mirëseardhje në teatër. Në shenjë të një dashamirësie të veçantë ndaj meje, mua më nderuan duke më dhuruar një hark dhe shigjeta, të cilat do t'i var mbi oxhakun tim, sapo Zoti t'u këtë siguruar një kthim të mbarë për në shtëpi këtyre mysafirëve të dashur." Në një letër të datës 17.1.1814 (WA IV, 24, 110), drejtuar djalit të tij August, ai shtoi:

"Shumë prej zonjave tona religjioze, kanë kërkuar me ngulm përkthimin e Kuranit në bibliotekat tona". ■

Përktheu nga gjermanishtja
Avni XHEMAJLI

Intervistë me Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit z. Memli Krasniqi

Krasniqi: Kultura dhe rinia, prioriteti ynë

Intervistoi: Valon GERBESHI

PAQJA: ***z. Krasniqi, nga pozita e zëdhënësit të Qeverisë, sot jeni në postin e ministrit të kulturës. Sipas jush, a është më lehtë të jesh zëri i qeverisë, apo i pari i një dikasteri kulturor, siç është Ministria e Kulturës?***

Krasniqi: Secila detyrë ka përgjegjësitë dhe vështirësitë e veta. Natyrisht të jesh ministër është një përgjegjësi më e madhe. Aq më tepër kur bëhet fjalë për një ministri që ngërthen në vete kulturën, sportin, rininë, trashëgiminë kulturore e shumë aspekte të tjera.

PAQJA: ***Pse kaluat në Ministrinë e Kulturës? Ishte motivi juaj për të kontribuar në sektorin e kulturës, kur dihet se juve personalisht ju lidh shumëçka me kulturën, apo ishit i nominuar nga kryeministri Thaçi ?***

Krasniqi: Ka qenë një besim që më është dhënë, duke pasur parasysh edhe angazhimet e mia të mëhershme rreth kulturës, rinisë, por edhe sportit. Unë edhe sa kam qenë deputet jam angazhuar shumë për këto fusha. Unë kam qenë anëtar i Komisionit Parlamentar për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe nga atje jam interesuar vazhdimisht për sferat që mbulon Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

PAQJA: ***z.Krasniqi, në çfarë gjendje e keni gjetur Ministrinë e Kulturës dhe me çfarë strategjie keni për ta ndryshuar situatën aktuale?***

Krasniqi: Realisht ka shumë probleme të trashëguara, projekte, ligje që janë zvarritur me vite të tëra. Përpjekja jonë është maksimale që të tejkalohen shumë sfida. Mund të them se ne, qysh në 100-ditëshin e parë, kemi arritur mjaft suksese, që për 10 vjet nuk janë bërë në këtë Ministri. Më lejoni këtu të përmend miratimin e Rregullores për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore, e cila përfundimisht e rregullon statusin legal dhe financiar të mbi 300 punonjësve, të cilët për dhjetë vjet kanë punuar me kontrata mbi vepër dhe paga shumë të ulëta. Tash, me këtë rregullore, ata kanë kontrata të rregullta pune dhe rritje në paga, që në shumë raste shkon edhe mbi 100%.

Rritja e buxhetit, për mbi 1 milionë e 300 mijë euro, është po ashtu një sukses dhe kjo normalisht që ka ndikuar që të rrisim investimet kapitale, si dhe të mbështesim edhe më shumë aktivitetet dhe projektet në kulturë, sport dhe për rini. Kemi mundësi më të mëdha për të plotësuar kërkesat e komunitetit artistik, sportiv dhe rinisë. Ligjet janë një fushë ku jemi duke punuar shumë po ashtu dhe tashmë shumë prej tyre, si ai për Sponsorizime dhe Donacione, Ligji i ri për Teatër, Ligji për Kinematografi dhe ligje të tjera tashmë janë në grupin punues qeveritar dhe pritet shumë shpejt të jenë për miratim. Dua të përmend këtu edhe punën që po bëjmë në përgatitjet e Dokumentit Strategjik Konservimi i Integruar, që është një element i rëndësishëm edhe për Raportin e Progresit. Po ashtu, po punojmë në strategjitë zhvillimore për kulturë dhe sport. Natyrisht ka edhe shumë të arritura të tjera të prekshme që janë realizuar në këtë 100 ditësh.

PAQJA: ***z. Krasniqi, a mendoni se kultura në të kaluarën ka qenë e lënë pas dore nga institucionet qeveritare?***

Krasniqi: Realisht në rrethana në të cilat ka qenë Kosova pas luftës, por edhe tash, ndoshta kultura ka qenë e arsyeshme që të mos jetë prioritet. Por kjo nuk e arsyeton faktin se megjithatë ka mundur të bëhet më shumë, sidomos në infrastrukturën ligjore dhe segmente të tjera, e po ashtu edhe në funksionalizimin e administratës dhe menaxhim më të mirë të mjeteve.

PAQJA: ***Në udhëheqjen tuaj, a do të jetë kultura prioritet nacional i Qeverisë së Kosovës ?***

Krasniqi: Kultura, sporti, trashëgimia kulturore padyshim që duhet të jenë prioritet. Gjithsesi ende nuk mund të pritet që të ketë zhvillime të mëdha për shkak të rrethanave dhe zhvillimeve në Kosovë. Zhvillimi i kulturës, sportit e segmenteve të tjera, që ka përgjegjësi MKRS, lidhen shumë edhe më zhvillimin ekonomik të vendit. Ajo që duhet theksuar është se tashmë ka një qasje shumë serioze për të ndryshuar gjërat me mundësitë aktuale, gjithmonë duke punuar që të rritet përkushtimi i të gjithëve për sportin dhe kulturën.


Memli Krasniqi



Vizion im është që të mos jemi ne ata që bëjmë rregulla se si të zhvillohet kultura ose sporti. Ne duam që të jemi lehtësues në këtë raport dhe detyrat kryesore t'i marrin njerëzit e thirrur për krijimtari kulturore, sportive etj.

PAQJA: ***z. Ministër, cilat janë projektet kapitale, të cilat ju synoni t'i realizoni gjatë udhëheqjes suaj?***

Krasniqi: Këtë vit, pjesën më të madhe të buxhetit e kemi orientuar në investime kapitale në sport, që kanë të bëjnë me rregullimin e infrastrukturës sportive. Bëhet fjalë për rinovimin e disa stadiumeve regjionale, si në Pejë e Prishtinë. Siç e dini, do të rinovohen 10 stadiume, tri prej të cilëve pritet të përfundojnë këtë vit dhe shtatë të tjerë në dy vitet e ardhshme. Jemi po ashtu duke punuar për renovimin dhe ndërtimin e palestrave sportive dhe poligoneve shkollore. Ne po shikojmë të gjitha mundësitë që, në bashkëpunim edhe me komunitetin e biznesit, të rrisim investimet në mënyrë që të kemi stadiume, objekte të kulturës që na bëjnë të krenohemi.

PAQJA: ***z. Ministër, të kalojmë në një temë tjetër, atë për të drejtat autoriale. Sa është punuar në këtë drejtim dhe kur do të miratohet ligji për të drejtat autoriale?***

Krasniqi: Plotësimi i Ligjit për të drejtat autoriale dhe të drejtat e përafërta tashmë është duke u bërë dhe pritet të jetë i gatshëm për miratim shumë shpejt. Zyra për të drejtat e autorit në MKRS ka tashmë staf shtesë të nevojshëm. Do të ketë në ditët në vazhdim hapa pozitivë në këtë drejtim.

PAQJA: ***Cilat janë raportet e MKRS-së me institucionet e tjera kulturore, si Teatrin, Kinematë, Filarmoninë, Galerinë dhe shumë të tjera.***

Krasniqi: Ato janë institucione që janë në kuadër të ministrisë dhe ne i mbështesim vazhdimisht ato me buxhet vjetor dhe mbështetjen e aktiviteteve të tjera, brenda kornizës buxhetore të paraparë.

PAQJA: ***Çfarë përkrahje financiare i ofron MKRS-ja këtyre institucioneve në realizimin e projekteve të cilat i ofrojnë këto institucione në ministri ?***

Krasniqi: E kuptojmë që kërkesat janë më të mëdha dhe të arsyeshme sesa mundësitë, por dua të them se synimi ynë është që të kemi vazhdimisht rritje për buxhetin e institucioneve kulturore.

PAQJA: ***Kur jemi te këto institucione kulturore, ka pasur kërkesë të hapur për shkarkimin e drejtorit të GAK-së, në adresë tuaj. A është shqyrtuar kjo kërkesë dhe cili është përfundimi i kësaj kërkese?***

Krasniqi: Ne kemi formuar komisionin që ka dëgjuar kërkesat e palëve. Ky komision ka dërguar çështjen në Këshillin Drejtues të Galerisë dhe nga aty kanë dalë disa rekomandime. Më pastaj është formuar Komisioni Disiplinor, i cili po e analizon këtë dhe pritet ta japë fjalën e vet.

Rreth 1.5 milion euro nga SHBA-të

PAQJA: ***Tash së fundi keni nënshkruar një marrëveshje ku SHBA-të pritet të ndajnë një donacion rreth 1.5 milion dollarë për trashëgiminë kulturore. Sa i ka ndihmuar ky donacion MKRS-së, në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe në çfarë projektesh do të shpenzohen këto fonde?***

Krasniqi: Memorandumi ka qenë një arritje po ashtu shumë domethënëse dhe për herë të parë për kaq kohë të shkurtër është siguruar një fond kaq i madh që do të ndihmojë shumë për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore. Unë dua ta falënderoj shumë ambasadën amerikane për ndihmën që ka dhënë në këtë drejtim. Tashmë pritet të përfundojnë të gjitha procedurat dhe detajet shtesë dhe të fillohet me restaurimin e gjashtë monumenteve të trashëgimisë kulturore në disa komuna të Kosovës.

MKRS-ja e interesuar për eksponatet kulturore

PAQJA: ***Kur jemi te trashëgimia kulturore. Në bisedimet që po zhvillohen me shtetin fqinj, Serbinë, a ka agjendë diskutimi për ndonjë temë kulturore siç janë eksponatet, të cilat janë vjedhur nga Beogradi para dhe gjatë luftës ?***

Krasniqi: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka pozicionin e qartë në këtë drejtim. Ne me kohë kemi marrë kërkesën nga Ekipi i Kosovës në këtë dialog dhe me kohë e kemi hartuar dhe

dorëzuar një strategji për kërkesat dhe pozicionet tona. Sa i përket artefakteve, ne kërkojmë që ato të kthehen sa më parë në Kosovë.

PAQJA: ***Kemi një popullsi kryesisht të re. Ministria juaj ka premtuar se do të mbrojë dhe promovojë interesat e rinisë kosovare. Sa janë të mbrojtura sot interesat e të rinjve nga MKRS-ja ?***

Krasniqi: Edhe në këtë drejtim ne kemi punuar mjaft në këtë periudhë. Kemi formuar për herë të parë Këshillin Qendror për Veprim Rinor, organ ky më i larti për përfaqësimin e interesave të të rinjve. Ky Këshill e ka mbështetjen tonë të plotë. Gjatë kësaj kohe kemi mbështetur dhjetëra projekte të organizatave rinore jo qeveritare. Kemi organizuar, në bashkëpunim me institucione të tjera vendore e ndërkombëtare konferenca me qëllim të nxjerrjes së ideve dhe projekteve që do të ndihmonin në punësimin e të rinjve. Punësimi i rinisë nuk është përgjegjësi vetëm e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Kjo është një sfidë nacionale dhe janë të angazhuara të gjitha institucionet më të larta shtetërore dhe ka edhe partnerë të fuqishëm ndërkombëtarë në këtë drejtim. Siç edhe e thashë, ne kemi bërë të gjitha përpjekjet që të arrijmë të gjejmë format se si rinia të mund të punësohet më shumë dhe të ketë perspektivë dhe avancim. Po ashtu, një angazhim i yni është që rinia të jetë sa më prezent në vendimmarrje. Dua të theksoj po ashtu se në Ligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të rinisë, sa kam qenë deputet në legjislaturën e kaluar, kam insistuar që në të të futet edhe vullnetarizmi, e ai të njihet si përvojë pune. Dhe kjo është arritur. Gjatë këtij 100 ditshi është lëshuar projekti për ndërmarrësi dhe projekte të ndryshme për punësim, në bashkëpunim me Bankën Botërore.



Infrastruktura sportive – shqetësuese për ministrinë

PAQJA: ***Sa jeni të kënaqur me gjendjen sportive në Kosovë?***

Krasniqi: Thënë realisht, gjendja mbetet shqetësuese si në aspektin infrastrukturor dhe atë të organizmit të federatave dhe klubeve. Natyrisht për këtë të fundit nuk është çështje që na takon neve të përzihemi shumë, por do të dëshironim dhe kërkojmë nga federatat dhe klubet që të kenë një angazhim edhe më të madh. Unë përmenda më herët për projektet aktuale dhe të ardhshmet, sa i përket infrastrukturës sportive. Pres që të ketë hapa të shpejtë dhe pozitivë nga të gjitha anët.

PAQJA: ***Cila është rruga që do të ndiqni për të ndërkombëtarizuar sportin në Kosovë?***

Krasniqi:Ne nuk mund të përfshihemi shumë në këtë proces, pasi kjo më shumë i takon Komitetit Olimpik të Kosovës dhe federatave në veçanti, të cilat ne i mbështesim fuqishëm. Por, natyrisht, ne nuk kemi heshtur në këtë drejtim dhe kemi shfrytëzuar të gjitha mundësitë që të lobojnë te mekanizmat ndërkombëtarë që të ketë një pranim të Kosovës, të paktën në këtë kohë për zhvillim të ndeshjeve miqësore ndërkombëtare, për shembull sa i përket futbollit. Ju e dini që kam takuar në Kosovë legjendën e futbollit gjerman Frenz Bekenbaur, i cili ka një rol të madh në FIFA. Ai ka premtuar ndihmën e tij, por natyrisht që adresa jonë kryesore është UEFA. Ne kemi plane konkrete se si t'i qasemi këtij angazhimi dhe do të shfrytëzojmë të gjitha rrugët ligjore që të ketë ndërkombëtarizim sa më të shpejtë, e po ashtu edhe sjellje të investimeve në Kosovë në infrastrukturën sportive. Një gjë e rëndësishme është që ne, përpos ndërkombëtarizimit, duhet të angazhohemi mjaft mirë brenda, pasi duhet të jemi të përgatitur si duhet në kohën kur do të pranohemi në mekanizmat ndërkombëtarë. ■

MIRË SE VJEN VERË, KUJDES NGA DIELLI

Artan BEJTA & Jehona SAHITI

Që të kemi shëndet të mirë, paraprakisht, duhet të kemi kujdes të shtuar ndaj shumë faktorëve. Tanimë, me fillimin e sezonit veror që të kemi një shëndet të mirë pa probleme duhet të kemi kujdes të shtuar ndaj temperaturave të larta të ditëve me vapë. Profesionistët mjekësorë japin shumë këshilla në lidhje me mbrojtjen nga vapa. Ata këshillojnë sidomos dy kategoritë më delikate dhe më të ndjeshme ndaj temperaturës së lartë: fëmijët e vegjël dhe të moshuarit.

Specialistët nga lëmi i pediatrisë theksojnë se temperaturat e larta mund të shkaktojnë një sërë problemesh te fëmijët, si të rrahura të shpeshta të zemrës, duke u bërë kështu shkak për probleme të tjera më serioze kardiovaskulare.



Dielli dhe ndikimi i tij

Rrezet e ngrohta të diellit na bëjnë të ndihemi mirë, mirëpo brenda vetes ato fshehin edhe rreziqe: rrezet e diellit përbëhen nga drita e dukshme (50%), rrezet infra të kuqe (44%) dhe ato ultra-vjollcë – UV (6%). Rrezet ultra-vjollcë përbëjnë shkaktarin kryesor për paraqitjen e kancerit të lëkurës dhe nxisin plakjen e parakohshme të lëkurës. Lëkura nuk fshin nga kujtesa e saj asnjë rreze dielli, sidomos asnjë djegie nga dielli – dhe kjo që nga fëmijëria! Djegiet nga dielli gjatë fëmijërisë shtojnë rrezikun e kancerit të lëkurës. Rrezet ultravjollcë i rrezikojnë edhe sytë e pambrojtur dhe mund t'u shkaktojnë atyre dëmtime të qëndrueshme.

Përse lëkura jonë ka nevojë për mbrojtjen nga dielli?

Lëkura mund t'i ekspozohet diellit për një kohë të caktuar pa u skuqur. Te njerëzit me lëkurë më të bardhë kjo periudhë kohore e ashtuquajtur e vetëmbrojtjes zgjat vetëm pesë deri dhjetë minuta. Në rast se ky hark kohor tejkalohet, lëkura ka nevojë për një mbrojtje përmes hijeve, rrobave adekuate ose preparateve për mbrojtje nga dielli. Personat me pigmentim më të errët i rezistojnë diellit pak më gjatë.

Goditja nga dielli, shumë e rrezikshme për të gjithë

Qëndrimet e gjata në diell sjellin deri te një pasojë, që është gjendja më e rëndë që mund të shfaqet dhe përbën një rast urgjent, që njihet si goditja nga dielli. Deri te kjo gjendje arrihet gjatë qëndrimeve të gjata në diell, që sjellin deri te prishja e aftësisë fiziologjike të rregullimit të temperaturës, kur kjo qendër nuk përballon rritjen e madhe të temperaturës trupore. Në këto kushte mund të ndodhë që organizmi të mos reagojë dhe të çojë deri në humbje të vetëdijes dhe probleme më serioze për jetën. Në këto raste kërkohet trajtim spitalor, por gjithsesi paraprakisht duhet pasur kujdes që i sëmuri të freskohet, të lirohet nga rrobat, si dhe t'i vendosen rroba të lagura më ujë të ftohtë. Goditja e diellit është urgjencë mjekësore që shfaqet menjëherë pas ekspozimit të kokës dhe qafës në diell, kur këto janë të pambrojtura.

Zakonisht sëmundja shoqërohet me shenja si: dhimbje shumë të forta të kokës, skuqje e fytyrës, të vjella, turbullim të vetëdijes dhe të dridhura. Të prekurit duhet të largohen nga qëndrimi në diell, pastaj duhen vënë kompresa të ftohta në ballë dhe kyçe dhe nevojitet pushim absolut në vend të freskët.


Kujdesi që duhet të kemi në ditët me diell

Shmangia nga dielli - Mënyra më e mirë për t'i ikur problemeve me vapën pa dyshim është shmangia nga dielli, e sidomos gjatë kohës kur temperaturat e larta e arrijnë maksimumin (mesditë) e sidomos kujdes të veçantë duhet të kenë ata që vuajnë nga ndonjë sëmundje (kardiovaskulare), pasi që sëmundje të ndryshme përkeqësohen gjatë qëndrimit të gjatë në temperatura të larta.

Ushqehuni në mënyrë të shëndetshme – Gjithashtu, kujdes i shtuar gjatë sezonit të verës duhet të tregohet edhe gjatë ushqyerjes, si në llojet e ushqimeve që konsumojmë, po ashtu edhe në mënyrën e përgatitjes së tyre. Kujdes të shtuar duhet të kemi gjatë marrjes së ushqimeve të qumështit, pasi që ato janë shpesh shkaktarë të problemeve të shumta shëndetësore, e sidomos atyre infektive.

Pemët dhe perimet, të nevojshme në ditët me vapë - Frutat dhe perimet, si një ushqim i mirë për shëndetin tonë e po ashtu jashtëzakonisht të konsumuara gjatë kësaj sezoni, duhet pasur kujdes që të jenë të lara mirë para ngrënies së tyre, pasi shpesh janë shkaktarë të infeksioneve të ndryshme të traktit tretës.

Merrni sasi të mjaftueshme të lëngjeve - Uji është lëngu më i mirë që e freskon organizmin tonë gjatë ditëve me vapë. Konsumojeni sa më shumë ujin, e po ashtu edhe ushqimet e lëngshme, duke mos lënë anash edhe lëngjet e tjera natyrale. Ushqimet e shpejta shpesh janë edhe të rrezikshme, kështu që ikni nga to, sidomos gjatë këtyre ditëve me vapë. ■





Intervistë me basketbollistin e Sigal Prishtinës, Blerim Mazrekun

Mazreku: Namazi im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Zotin e botëve!

Po e pres me shumë kënaqësi ardhjen e muajit të shenjtë ramazan. Me shumë kënaqësi do ta agjëroj këtë muaj të bekuar. Agjërimi i këtij muaji te muslimani as që duhet të diskutohet - ka thënë për revistën "Paqja" basketbollisti i Sigal Prishtinës, Blerim Mazreku

Intervistoi: Alban BILALLI

Blerim Mazreku është pa dyshim njëri nga basketbollistët më të mirë që ka Kosova. Qendra e Sigal Prishtinës ka qenë njëri nga protagonistët kryesorë në sukseset e klubit të kryeqytetit. Në intervistën dhënë për revistën "Paqja", Mazreku flet për fillimet e tij në futboll dhe për ofertat nga klubet jashtë Kosovës. Po ashtu, ai flet për stinorin që përfundoi ditë më parë. I pyetur rreth jetës private, Mazreku flet me mburrje se ka kohë të shkojë edhe në fakultet, si edhe t'i kryejë obligimet fetare. Për më shumë flet në një intervistë për revistën "Paqja", basketbollisti i Sigal Prishtinës, Blerim Mazreku.

PAQJA: *Na flitni për fillimet tuaja në basketboll.*

Mazreku: Kam filluar në vitin 2000 të ushtroj dhe të luaj basketboll, në klubin Ylli nga Theranda. Njëherësh në këtë klub ishin edhe hapat e parë drejt basketbollit. Pastaj karrierën e kam vazhduar në klubin Mabetex nga Prishtina. Në këtë klub kam filluar ta ndiej veten si basketbollist dhe të mendoj se unë mund të kem një karrierë të mirë, ngase ky klub na ka ofruar kushte shumë të mira. Në këtë klub kam qëndruar 4 vite, derisa Mabetex u largua nga garat.

PAQJA: *Pas Mabetex-it, në cilat klube keni luajtur?*

Mazreku: Vazhdova të luaj në skuadra të ndryshme të Kosovës: AS Prishtina, Bashkimi, Sigal Prishtina. Jashtë Kosovës kam luajtur në klubin Akropol në Suedi, në klubin Duhok nga Iraku, Al Arabi nga Katari, La Gulette-Hakulëid nga Tunizia. Në klubet jashtë Kosovës ka qenë karriera dhe sukseset më të mira në profesionin tim si basketbollist. Titujt që i kam fituar kanë qenë në Mabetex në vitin 2004-2005, pastaj sukseset më të mëdha kanë qenë në klubin e kryeqytetit Sigal Prishtina, klub me të cilin kam fituar 3 tituj e 2 kupa në vitet 2006-2007, 2007-2008 dhe 2010-2011. Për rreth 10 vite kam qenë edhe në Kombëtaren e Kosovës, ku kemi luajtur shumë lojëra jashtë Kosovës, e kjo ishte një eksperiencë shumë e mirë për mua, kur dihet se përfaqësoja vendin.

PAQJA: *Tani jeni anëtar i Prishtinës, si shkoi ky sezon për ju?*

Mazreku: Në Sigal Prishtinë ishte një sezon shumë i mirë, ku në fund fituam edhe titullin e kampionit. Ky ishte edhe synimi ynë. Në këtë klub kam kaluar shumë mirë, kur dihet se sukseset nuk kanë munguar.

PAQJA: *Keni oferta për të luajtur në klube jashtë Kosovës?*

Mazreku: Tani jam në pushim, në



shtator fillon prapë kampionati i basketbollit dhe normal pres oferta nga skuadrat jashtë vendit. Pres nga menaxherët, me të cilët jam në kontakte, të më gjejnë një klub të mirë jashtë Kosovës. Nëse nuk do të gjej klub jashtë Kosovës, atëherë do luaj në njërën nga ekipet e Kosovës.

PAQJA: ***Pos basketbollit, me çka merreni?***

Mazreku: Përveç basketbollit jam edhe absolvent në Universitetin e Prishtinës, në drejtimin Ekonomik-Menaxhment-Informatikë. Së shpejti do diplomoj, e të shoh çka do të vazhdoj në master. Nuk kam ndonjë punë tjetër, ngase dua të jem tamam profesionist në basketboll, e kur të përfundoj karrierën time si basketbollist, atëherë do vendosi se me çka do të merrem.

PAQJA: ***Njiheni si musliman i devotshëm, kur jeni falur për herë të parë?***

Mazreku: Unë nuk them që jam i devotshëm, por pretendoj gjithnjë të jem prej atyre të cilët Allahu i ka përmend në Kuran, se si duhet të jetë një njeri i devotshëm. Për herë të parë kam filluar ta fal namazin në vitin 2001, falënderoj Allahun që më ka udhëzuar në rrugën e drejtë.

PAQJA: ***A ju pengon namazi gjatë aktiviteteve të basketbollit?***

Mazreku: Gjatë aktiviteteve në basketboll, namazi nuk më pengon asnjëherë. Sikur të më pengonte, atëherë do të duhej ta lija basketbollin, ngase namazi im, jeta ime dhe vdekja ime, janë thjesht për Zotin e botëve.

PAQJA: ***Tani po afrohet ramazani, a do të agjëroni?***

Mazreku: Po e pres me shumë kënaqësi muajin e shenjtë ramazan. Me shumë kënaqësi do ta agjëroj këtë muaj të bekuar. Kjo te muslimani as që duhet të diskutohet.

PAQJA: ***A keni agjëruar ramazanin e kaluar? A ju pengon ramazani në stërvitje dhe në ndeshje zyrtare?***

Mareku: Padyshim që kam agjëruar. Prej se kam përqafuar Islamin, e kam agjëruar muajin ramazan. Ky është obligim fetar, kushti i katërt i Islamit. Mua nuk më pengon në stërvitje, as



në ndeshje zyrtare. Është shumë normale që në disa raste të ketë vështirësi, por duhet ta ndiejmë ramazanin, e pas vështirësive vjen lehtësimi.

PAQJA: ***Cili është reagimi i trajnerëve tuaj kur ju agjëroni?***

Mazreku: Ka pasur reagime të trajnerëve të ndryshëm, e sidomos ata kroatë, të cilët kanë qenë të krishterë, me pretendimin e tyre se nuk do të shkoj përpara nëse agjëroj, por Allahu është Ai që ma mundësoi t'i kapërcej këto "përralla" të tyre. Sa i përket trajnerëve nga Kosova, këta janë mësuar që Blerim Mazreku e agjëron ramazanin.

PAQJA: ***Njihni sportistë të tjerë që e falin namazin në klubin tuaj, por edhe në klubet e tjera të Kosovës?***

Mazreku: Po njoh basketbollistë. Te ekipi im janë Muhamed Hasani dhe Fahri Breca. Ka edhe në ekipet e Kosovës. Te klubi Bashkimi nga Prizreni janë dy basketbollistë që falin namazin, Artin Gashi dhe Urim Zenelaj. Edhe në ekipin e Vushtrisë ka basketbollistë që e falin namazin. Po ashtu edhe nga Mitrovica, në klubin Trepça janë disa basketbollistë që falin namazin, si Brahim Veseli, Drilon Hajrizi, ndërsa basketbollistë që e falin namazin e xhumasë ka më shumë. ■